

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7847 E mërkurë 10 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Nga XHEVAT MUSTAFA

Shumë turistëve të huaj, por edhe Semigrantëve shqiptarë, që vijnë rrallë në vendlindje, u bën përshtypje jo vetëm numri shumë i madh i dhe dendësia e ...

Vijon në faqen 21

Opinion *i* **Ditës**

Nga ELSA RAKIPLLARI

Çështjet e gjuhës iu japin kurdoherë të gjithëve, profesionistë a profanë, fije serioze për të tjerë. Kjo jo vetëm falë raportit të vetvetishëm që kanë folësit ...

Vijon në faqen 21



MESYME ME ARME BRENDA NE PISTEN E AEROPORTIT, 5 VETE TE ARMATOSUR RENDE GRABISIN PARATE QE DERGOHESHIN NE AUSTRI

GRABITEN 10 MILIONE EURO

Çahet Rinasi, policia vret "komandon" e maskuar

- Flasin pasagjerët e avionit: kujtuam se ishte stërvitje. 40 vetë të shoqëruar, pritën 4 urdhërarreste
- Autorët djejin furgonin me mbishkrimin 'Hetimi Tatimor'. Precedentët, siguria e aeroportit u çahet edhe në vitin 2016

TIRANË - E menduar dhe e planifikuar në detaje ashtu si në një film aksion që mund ta kemi parë me qindra herë në televizor. Gjithçka shkoi si duhet, deri në momentin që njëri prej 5 grabitësve u vra. Grabitja e djeshme brenda vendit ndo-shta më të sigurt në Shqipëri, aeroportit "Nënë Tereza" ...

Vijon në faqet 2-3



(Në foto:) Pamje nga grabitja në Rinas

Aksion për zgjerimin e bulevardit, përplasje me banorët, përdorët gaz lotsjellës

Luftë me policinë te Bregu i Lumit, 7 vetë në spital

Meta: Të hetohet dhuna e përdorur. Veliaj: Shtëpitë janë pa leje

Shemben 7 shtëpi në Bregun e Lumit, ndërsa procesi u shoqërua me dhunë e përplasje me banorëve e policisë. Banorët bënë rezistencë për të mos iu shembur shtëpitë ndërsa nga policia u përdor gaz lotsjellës për t'i nxjerrë ata jashtë. Të paktën kështu u raportua

nga gazetarët që ndoqën situatën. Sipas banorëve, 38 banesa u përjashtuan nga skema e dëmshpërblimit, ndërsa bashkia pretendon se ata nuk kanë asnjë dokument dhe kanë ndërtuar pa leje. Atyre i është ofruar vetëm bonus qiraje dhe hapësirë për kredimarrje të butë



ose banesa sociale. Pjesa tjetër e banorëve kërkojnë dëmshpërblimin para se të kryhen punimet. Këto janë dy grupimet që bëjnë rezistencë për mosshëmbjen e shtëpive, të cilat do i japin drejtim, fillimisht të punimeve për zgjerimin e bulevardit ...

Në faqet 8-9

MESAZHI I PALMER

Zyrtari i DASH në Tiranë: Qeveria është legjitime, opozita të hyjë në zgjedhje

Në faqen 5

LEGALIZIMET

Ndërtimet pa leje, 200 familjet që marrin tapitë në Tiranë dhe rrethe

Në faqet 10-11

ZV/MINISTRI I JASHEM

Gent Cakaj: Hiqen 350 pasaporta diplomatike në kundërshtim me ligjin

Në faqen 6

PESHENGRITJE

Briken Calja, kampion Europe në shtytje, nën-kampion në dygarësh

Në faqen 22

GRABITJA NE RINAS NGJARJA

Aksioni, arrestohet një nga grabitësit. Policia: Është i plagosur

Supergrabitja në Rinas, autorët me armë në shkallët e avionit

Hajduti i vrrarë, me mjekër e flokë të shkurtër, por i maskuar si "tullac"

TIRANË

Emenduar dhe e plani fikuar në detaje ash tu si në një film akcion që mund ta kemi parë me qindra herë në televizor. Gjithçka shkoi si duhet, deri në momentin që njëri prej 5 grabitësve u vra. Grabitja e djeshme brenda vendit ndoshta më të sigurt në Shqipëri, aeroportit "Nënë Tereza", madje brenda avionit ka lënë shumekënd pa mend se si është realizuar. "News 24" ka siguruar pamjet ekskluzive të qarta të grabitjes. Bëhet fjalë për momentin kur grabitësit të armatosur i janë afruar avionit dhe kanë kryer grabitjen e 10 milionë eurove në pak minuta, ndërsa në avion ndodheshin 160 pasagjerë që prisnin të udhëtonin drejt Vjenës. Në pamje duket një person i ngjashëm me personin e vrrarë, me syze, por pa maskë në fytyrë, jelek të zi dhe pantallona të zeza. Ai ndodhet anash avionit, pranë barkut, ku ndodheshin edhe paratë. Para tij, ndodhet grabitësi tjetër, por me uniformë tjetër, me lara ushtarake (uniformë operationale) teksa me armën e ngritur kërcënon punonjësit. Të dy mbajnë në duar doreza.

Po kështu duken edhe bagazhet teksa futen në avion. Në fotot e publikuara nga "News 24" grabitësi që mbeti i vrrarë duket me flokë të rëna, një imazh ky ndoshta tipik për rolin e interpretuar dje, rolin e fundit të jetës, atë të një grabitësi. I tillë shfaqet i riu i vrrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë pas grabitjes së 10 milionë eurove në Rinas. Por, në fakt, është vetëm një mbullim. Bëhet fjalë për një maskë gome që përdoret gjerësisht nga grabitësit dhe përveç fytyrës, shkon deri në pjesën e barkut. Ndërkaq, burime nga grupi hetimor bëjnë me dije për "GSH" se viktimia në të vërtetë është me mjekër dhe flokë të prera shkurt.



Mësohet se grabitësi i vrrarë është identifikuar por emri i tij nuk behet publik për arsye hetimore. Ndërkaq, mësohet se në trupin e grabitësit të vrrarë janë gjetur dy kallëpe dinamit të vendosur në brez, ndërsa në dorë kishte një granatë. Mendohet që perso-

ni i vrrarë është ai që ka shkëmbyer zjarr me policinë. Shkëmbimi i zjarrit ka ndodhur teksa grabitësit zbraznin tashtë nga furgoni që grabitën në tjetrin me të cilin u larguan. Pak orë pas grabitjes u zbuluan detaje të reja në lidhje me ngjarjen.

PRECEDENTËT E GRABITJEVE NË RINAS

Më 9 shkurt 2017, dy makina të blinduara që transportonin paratë e Bankës Kombëtare Tregtare drejt aeroportit të Rinasit u grabitën. Autorët morën 2.7 milionë euro që do të dërgoheshin në Austri. Në 30 qershor 2016 brenda pistës së aeroportit "Nënë Tereza" u grabitën 990 mijë euro. Autorët çanë rrethimin e aeroportit dhe hynë brenda territorit të tij me një automjet tip "Benz-Mercedez" ngjyrë të kuqe. Më 3 dhjetor të vitit 2015 u sulmua me armë eskorta e vlerave monetare Rogat Security, në aksin Tiranë-Rinas, në afërsi të Qafës së Kasharit, ku persona të veshur me uniformë policie arritën të merrnin një sasi prej 3.8 milionë euro.

Burime policore thanë se makina e përdorur rezultoi të jetë e vjedhur në Laç. Ndërsa grabitësit, siç shprehen blutë, kanë vepruar me një disiplinë ushtarake. Personi që shkëmbeu zjarr me policinë kishte detyrë të digjte makinën me logon "hetimi tatimor", ndërsa katër të tjerët janë larguar me një furgon tjetër, që e dogjën në Kamzë. Po të njëjtat burime bënë me dije se grabitësit kanë qenë njohës të mirë të zonës dhe e kanë mirëmenduar rrugën e largimit, pas ekzekutimit të kësaj vjedhjeje. Në orët e vona të mbrëmjes burime policore bënë me dije se është kapur një nga autorët e dyshuar të "megagrabitjes" së 10 milionë eurove në aeroportin e Rinasit. Sipas policisë ai është i plagosur.



Grabitësit me armë në shkallët e avionit (në rreth poshtë) grabitësi i vrrarë

GRABITËSI I VRRARË

Pak orë pas grabitjes u zbuluan detaje të reja në lidhje me ngjarjen. Burime policore thanë se makina e përdorur rezultoi të jetë e vjedhur në Laç. Ndërsa grabitësit, siç shprehen blutë, kanë vepruar me një disiplinë ushtarake. Personi që shkëmbeu zjarr me policinë kishte detyrë të digjte makinën me logon "hetimi tatimor", ndërsa katër të tjerët janë larguar me një furgon tjetër, që e dogjën në Kamzë.



Grabitja në avion, dëshmia e pasagjerëve: Autorët si komando, kujtuam stërvitje

TIRANË - Pas ngjarjes së bujshme në aeroportin e Rinasit, "Gazeta Shqiptare" ka arritur të sigurojë dëshmitë e pasagjerëve të avionit, me të cilin do të transportoheshin paratë e grabitura nga ky aeroport drejt Vjenës. Mësohet se paratë kanë qenë në një avion të linjës Tiranë-Vjenë, ku ndodheshin edhe 160 pasagjerë që do të udhëtonin drejt Austrisë drejt orës 15:05. Pasagjerët kanë thënë se kanë parë personat të veshur me rroba si komando të afroheshin tek barku i avionit dhe kanë kërcënuar punonjësit. "Avioni ishte i ndezur dhe pamë nga ana e djathtë e avionit tre persona me kapuç në kokë, të veshur si komando të afroheshin tek barku i avionit. Kujtuam se bëhej fjalë për një stërvitje. Ata kanë kërcënuar me kallashnikov punonjësit dhe i urdhëruan të shtrihen", kanë thënë pasagjerët. Më pas autorët kanë marrë paratë në barkun e avionit dhe janë larguar fillimisht me këmbë e më pas me një furgon. Po kështu "GSH" mëson se pak minuta pas grabitjes ka hyrë policia në avion dhe ka kërkuar pamje, por pasagjerët kanë thënë se nuk kanë filmuar. Policia ka zbritur pasagjerët më pas nga avioni për të kryer hetime të mëtejshme. Por ditën e djeshme, avioni i linjës "Austrian Airlines", nuk u nis në orarin e përcaktuar për shkak se pesë grabitës të armatosur dhe të maskuar hynë brenda tij për të vjedhur 10 milionë euro. Një kompani private e sigurisë kishte dorëzuar shumë e madhe të parave brenda avionit, për t'u transportuar drejt shtetit austriak. Përballë situatës së pazakontë ku u gjetën dhjetëra pasagjerë, fluturimi drejt Vjenës nuk u krye në orarin e përcaktuar.

Ngjarja spektakolare, shoqërohen 40 persona dhe lëshohen 4 urdhër-arreste

Grabiten 10 mln euro në pistën e aeroportit të Rinasit, ekzekutohet 1 nga 5 autorët

Zbardhet dinamika e ngjarjes, ja si i vodhën "komandot" paratë që do të transportoheshin për në Vjenë

TIRANË

Një grabitje spektakolare ka ndodhur pasditën e djeshme në pistën e aeroportit "Nënë Tereza" të Rinasit. Pesë persona të maskuar dhe të armatosur kanë arritur të futen brenda në pistë me një furgon me ngjyrë të bardhë dhe me mbishkrimin "Hetimi tati-mor". Ata i janë afur avionit të linjës Tiranë-Vjenë ku ndodheshin 160 pasagjerë, të cilët do të udhëtonin drejt Austrisë dhe kanë arritur të marrin një shumë që dyshohet të kapë vlerën 10 milionë euro. Supergrabitja është shënuar në orën 15:00 dhe është kryer në kohë rekord. Autorët të mirinformuar se në atë orar 4 banka të nivelit të dytë do të transportonin një sasi të konsiderueshme valute drejt Austrisë, të armatosur me kallashnikov dhe të veshur me kostume kamuflazhi, kanë vënë në jetë planin e grabitjes. E gjithë grabitja, e cila ngjante me skenarët e filmave hollivudianë është parë nga pasagjerët brenda në avion, të cilët kanë kujtuar as në pyetje një stërvitje policore. Ndërkohë, burime nga grupi hetimor bënë me dije se kompania që merret me sigurimin e aeroportit, ICTS Albania, ka pikasur grabitjen dhe ka njoftuar policinë. Menjëherë, blutë janë vënë në ndjekje të agresorëve dhe kanë mundur të vrasin njërin nga grabitësit, rreth 2 km larg aeroportit, pasi ata kishin marrë paratë nga katër makina blind të transportit të parave të 4 kompanive të ndryshme private, dy prej të cilave, "Nazeri 2000", "Octopus" dhe "Anakonda".

Mësohet se autorët e grabitjes janë larguar në një rrugë dytësore, por aty janë përballur me një makinë dhe Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë, e cila ka qenë në patrullim rutinë. Nga frika e kapjes, grabitësit kanë sulmuar me kallashnikov dhe granata FNSH-në, e cila është përgjigjur me zjarr: Si pasojë shkëmbimit të zjarrit ka mbetur i vrarë me plumb në kokë njëri nga grabitësit. Bashkëpunorët e viktimës, kanë marrë trupin e pajetë dhe e kanë hedhur nga furgoni për të humbur gjurmët dhe janë arratisur. Kur është gjetur



Policia në aeroportin e Rinasit

POLICIA DHE FORCAT SPECIALE

Ngjarja e rëndë, e cila ka cenuar rëndë sigurinë kombëtare ka alarmuar Policinë e Shtetit. Mësohet se forca të shumta policore të Tiranës, dhe ato special (RENEA dhe FNSH) të ndihmuara nga një helikopter janë vënë në ndjekje të autorëve të grabitjes. Të angazhuara në operacionin e gjerë janë edhe forca nga policia e Lezhës, Dibërës dhe Durrësit.

nga policia, viktima nuk ka pasur asnjë mjet identifikimi në trup dhe nuk dihet ende emri i tij. Ngjarja e rëndë, e cila ka cenuar rëndë sigurinë kombëtare ka alarmuar Policinë e Shtetit. Mësohet se forca të shumta policore të Tiranës, dhe ato speciale (RENEA dhe FNSH) të ndihmuara nga një helikopter janë vënë në ndjekje të autorëve të grabitjes. Të angazhuara në operacionin e gjerë janë edhe forca nga policia e Lezhës, Dibërës dhe Durrësit. Në lidhje me këtë ngjarje të rëndë janë shoqëruar dhe marrë në pyetje 40 persona, ndërsa janë lëshuar dhe 4 urdhër-arresti për personat përgjegjës të sigurisë brenda aeroportit të Rinasit.

DINAMIKA E NGJARJES

Zbardhet dinamika e grabitjes së bujshme në aeroportin e Rinasit. Pesë grabitësit të veshur si forcat komando dhe me maska në kokë (kapuçë), kanë qarë derën e rrethimit të pistës së aeroportit që përdoret nga zjarfikësit. Ata kanë hyrë në zonën kargo të aeroportit, pak pasi disa kompani sigurimesh kanë ngarkuar në avion paratë që do të dërgo-

heshin jashtë vendit. Tre kanë hyrë brenda pistës dhe kanë marrë paratë, dy të tjerë kanë qëndruar në makinë. Pasi kanë marrë thasët me para, grabitësit kanë përdorur mjetin e "Tatimeve" për të qarë një derë me hekura, e cila ndodhet në fundin e pistës së aeroportit. Në momentin që grabitësit janë larguar nga Rinasit, në ndjekjen e tyre janë vënë grupi i gatshëm i FNSH-së dhe policisë që ndodhet për patrullimet rutinë në aeroport. Sipas burimeve policore, gjatë tentativës së arratisjes ka patur shkëmbim zjarri me grabitësit e armatosur. Këta të fundit kanë hapur zjarr me kallashnikovë dhe kanë sulmuar forcat e FNSH-së me granatë. Gjatë shkëmbimit të zjarrit njëri prej tyre në tentativë për të goditur forcat e rendit ka mbetur i vrarë me një plumb në kokë. Pas disa manovrash, grabitësit janë larguar në një rrugë dytësore, ku kanë braktisur furgonin e bardhë dhe pa targa që përdoren për të hyrë në Rinas. Ndërkohë kanë përdorur dhe një makinë të dytë për t'i shpëtuar ndjekjes së policisë. Forcat e rendit e gjetën makinën e "Tatimorëve", e cila u përdor për



Furgoni i bardhë me të cilin u morën paratë

40 TË SHOQËRUAR

Në lidhje me ngjarjen të rëndë të ndodhur në aeroportin e Rinasit, janë shoqëruar dhe marrë në pyetje 40 persona, ndërsa janë lëshuar dhe 4 urdhër-arresti për personat përgjegjës të sigurisë brenda aeroportit të Rinasit. Ky është rasti i dytë i grabitjes së parave brenda pistës së aeroportit të Rinasit dhe i katërti i grabitjes së parave të bankave që shkojnë drejt Rinasit.

grabitjen rreth 2 km larg aeroportit. Ajo ishte e braktisur në një rrugë dytësore, e cila është e njohur në zonë si rruga e "Tahirëve". Në vendngjarje policia ka gjetur disa armë kallashnikov si dhe disa granata ofensive. Një tjetër furgon, thanë burimet policore, është gjetur i djegur në afërsi të Kamzës (poshtë Urës së Tapizës) dhe besohet se është përdorur nga po të njëjtët grabitës si mjet largimi drejt Laçit ose Lezhës.

GRABITËSI I VRARË

Policia është gjetur në vështrësi për të identifikuar një prej autorëve të grabitjes që mbeti i vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit. Burime për "Gazeta Shqiptare" pohuan se viktima nuk ka pasur asnjë mjet identifikimi me vete dhe kjo e ka bërë të vështirë punën e hetuesve për të zbuluar emrin e tij dhe avancuar me hetimet. Për këtë arsye, policia ka marrë një pajisje të kompanisë Aleat që prodhon pasaportat dhe kartat e identitetit dhe e kanë çuar në vendin ku u gjeta viktima. Mësohet se policia ka marrë shenjat e gishtave të personit që u gjet i vdekur; për të verifikuar nëse ka apo jo precedent penalë dhe janë duke marrë in-

formacion për lidhjet e tij shoqërore e familjare. Viktima, me flokë të rëna ose i qethur zero, u gjet pranë lumit në urën e Brarit. I veshur me troba të zeza të ngjashme me ato komando, të kompletuar deri në detaj, me paraqitje e anti-plumb. Por sipas informacioneve të siguruar nga "GSH" uniforma e veshur nga viktima dhe grabitësit e arratisur është turke dhe është hequr nga përdorimi prej shumë vitesh. Këto uniforma shiten në dyqanet që shesin pajisje dhe uniforma ushtarake. Në Tiranë janë vetëm dy subjekte të tilla. E ndërsa ka vijuar puna për identifikimin e grabitësit të vrarë, morgu i Tiranës është mbushur plot me familjarë, persona që dyshojnë se i vrari mund të jetë i afërm i tyre. Pas verifikimeve të bëra është bërë e mundur identifikimi i tij. Ndërkaq, policia dhe prokuroria janë duke hetuar intensivisht për zbardhjen e plotë të grabitjes spektakolare. Mësohet se hyrja dhe dalja e grabitësve është fiksur nga një kamerë sigurie, filmimet e të cilës po analizohen nga grupi hetimor nën drejtimin e prokurorëve të Krimeve të Rënda, Ndini Tavani dhe Kreshnik Ajazi.

Akuzat e opozitës, ministri Lleshaj: Lufta nuk mund të ndalet nga askush

TIRANË - Grabitja e 10 milionë eurove në aeroportin "Nënë Tereza" në Rinas ka ngritur në këmbë Policinë e Shtetit. Jo vetëm grupi i ekspertëve, por në vendin e ngjarjes kanë mbërritur pasditën e djeshme edhe drejtori i Policisë së Shtetit, Ardë Veliu dhe kryepolici i Tiranës, Reban Jaupi. Mësohet se Lleshaj ka telefonuar Velium, duke i kërkuar që të zbardhin menjëherë grabitjen dhe të vënë para drejtësisë personat përgjegjës. Pavarësisht angazhimit të policisë për zbardhjen e ngjarjes së rëndë, opozita ka sulmuar dhe akuzuar ashpër kryeministrin Rama dhe ministrin e Brendshëm, Sandër Lleshaj, duke thënë se nuk kanë kohë të merren me sigurinë publike, por e angazhojnë Policinë e Shtetit kundër qytetarëve duke u hapur rrugën grabitjeve dhe vrasjeve. I menjëhershëm ka qenë reagimi i ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj. Ai ka deklaruar duke thënë se lufta nuk mund të ndalet nga askush, edhe pse policia sulmohet nga zëdhënësit/sekretarët i një partie antiparlamentare, referuar deklaratës së Gazmet Bardhit. Ndërkëq, hetimet për zbardhjen e grabitjes së bujshme në Rinas po kryhen nën drejtimin e dy prokurorëve të Krimeve të Rënda, Ndini Tavani dhe Kreshnik Ajazi.

KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha në një postim në Twitter informoi dje se biseda me zëvendësndihmësin e Sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer ka qenë e hapur dhe konstruktive, lidhur me krizën politike dhe institucionale në vend. Kreu i opozitës, u shpreh se në takimin me zëvendësndihmësin e Sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, është diskutuar në lidhje me krizën politike dhe institucionale në vend. "Bisedë e hapur dhe konstruktive me Matthew Palmer mbi situatën: mungesën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, pandëshkueshmëria, krimi, korrupsioni dhe kriza politike. Përkushtim i përbashkët për demokraci, shtetin e së drejtës dhe mirëqeverisjen si rruga e vetme për stabilitet dhe Shqipërinë në BE", deklaroi z.Basha.

TAKIMET

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, ka nisur këtë javë një tur kombëtar me qëllim bashkimin e sa më shumë shqiptarëve në protestën e 13 prillit. Në takimet në Kukës dhe Kurbin, dhe më pas në Elbasan dhe Durrës kreu i opozitës u kërkoi demokratëve të jenë pranë qytetarëve njësoj si në fushatë për të afruar ditën e largimit të kryeministrit më të korruptuar në Europë, i kapur duke vjedhur votat, paratë dhe pasuritë e shqiptarëve. Z.Basha u tregua i prerë, duke përjashtuar çdo mundësi dialogu me mazhorancën. Sipas Bashës nuk do të ketë zgjedhje në vend, derisa të garantohen dhe pranohen kushtet dhe standardet e kërkuara nga opozita. "Asgjë nuk do të përparojë, asnjë dialog nuk do të nisë pa larguar shkaktarin dhe arkitektin e narco-shtetit. Dhe mesazhi që kumbon kudo është ky: Nuk do të ketë më demokraci false, nuk do të pranojmë më parlament fals, nuk do të pranojmë më drejtësi fals, nuk do të pranojmë më ekonomi fals. Është koha për Shqipërinë e demokracisë së vërtetë, lirisë së vërtetë, Shqipërinë e vlerave të vërteta evropiane. Por miqtë e mi, zgjedhjet nuk do të mbahen nesër. Dhe zgjedhjet në Shqipëri nuk do të ketë pa garantuar kushtet dhe standardet që kurrë më krimi dhe kriminelët, hajdutët dhe oligarkët, të mos diktojnë një tjetër fals-parlament dhe një tjetër false-qeveri",

Kreu i PD: Nëse zgjedhjet do të mbaheshin nesër, shqiptarët do t'i jepnin mandatin qeverisës opozitës

Takimi me Palmer, Basha: Bisedë e hapur dhe konstruktive

"Nuk do të ketë dialog pa largimin e Ramës"

theksoi z.Basha. Kreu i demokracisë u kërkoi qytetarëve që të bashkohen në protestën e 13 prillit. "Ne kemi një program që do ta nxjerrë Shqipërinë nga kriza ekonomike, dhe ne e dimë se ky program është pro-

grami fitues në zgjedhje, prandaj sfida jonë është që ta bëjmë realitet një orë e më shumë. Duhet të krijojmë kushtet për zgjedhje të lira e të ndershme, kushte të cilat nuk mundet dot të krijohen pa larguar Edi Ramën, pa larguar kupolën e tij, të kapur duke vjedhur zgjedhjet e 2017-s, në bashkëpunim me krimin e organizuar", -u shpreh kreu i opozitës. Sipas tij vendi ka nevojë për ndryshim dhe drejtësi të vërtetë për të guarr vendin drejt integritimit Evropian. "Të gjitha sondazhet e PD, të aleatëve tanë, të kundërshtarit tonë politik dhe ato të ashtuquajturat të pavarura, konfirmojnë se sot PD është shumicë absolute dhe, bashkë me koalicionin tonë, është gati që në një proces të lirë zgjedhor të marrë përgjegjësitë e drejtimit dhe qeverisjes së Shqipërisë drejt destinimit tonë evropian. Shumica dërrmuese e shqiptarëve, nëse zgjedhjet do të mbaheshin nesër do t'i jepnin mandatin qeverisës opozitës. Por miqtë e mi, zgjedhjet nuk do të mbahen nesër. Dhe zgjedhjet në Shqipëri nuk do të ketë pa garantuar kushtet dhe standardet që kurrë më krimi dhe kriminelët, hajdutët dhe oligarkët, të mos diktojnë një tjetër fals-parlament dhe një tjetër false-qeveri", u shpreh Basha.

TAKIMI

"Bisedë e hapur dhe konstruktive me Matthew Palmer mbi situatën: mungesën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, pandëshkueshmëria, krimi, korrupsioni dhe kriza politike. Përkushtim i përbashkët për demokraci, shtetin e së drejtës dhe mirëqeverisjen si rruga e vetme për stabilitet dhe Shqipërinë në BE", tha z.Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dhe me Matthew Palmer


ZGJEDHJET

"Shumica dërrmuese e shqiptarëve, nëse zgjedhjet do të mbaheshin nesër do t'i jepnin mandatin qeverisës opozitës. Por miqtë e mi, zgjedhjet nuk do të mbahen nesër. Dhe zgjedhjet në Shqipëri nuk do të ketë pa garantuar kushtet dhe standardet që kurrë më krimi dhe kriminelët, hajdutët dhe oligarkët, të mos diktojnë një tjetër fals-parlament dhe një tjetër false-qeveri", u shpreh Basha.



Presidenti Meta me Palmer: Situata politike në vend, e vështirë

Presidenti i Republikës Ilir Meta priti dje zëvendësndihmësin Sekretarin e Shtetit për Europën, Matthew Palmer. Në një postim në faqen e tij zyrtare rreth këtij takimi, Kreu i Shtetit e cilëson si të vështirë situatën politike në vend, temë mbi të cilën ai ka diskutuar me zyrtarin amerikan. "Takim i hapur dhe miqësor me zëvendësndihmësin Sekretarin e Shtetit për Europën, Matthew Palmer mbi situatën e vështirë politike në vend dhe rrugëdaljet për të ecur përpara. Interesi i ndërsjellë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, që qëndrojnë në themel të partneritetit strategjik mes dy vendeve", -shprehet Presidenti Ilir Meta. Më herët gjatë ditës së djeshme, Palmer zhvilloi takim edhe kreun e PD-së, Lulzim Basha si dhe me kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi.




Takimi me Palmer, Kryemadhi: Hallet tona do t'i zgjidhim ne shqiptarët

Kryetaria e LSI-së Monika Kryemadhi për rreth 70 minuta takoi dje zëvendës Sekretarin amerikan, Matthew Palmer. Kryemadhi, në një prononim për gazetaret u shpreh se nuk është e autorizuar të flasë rreth asaj që diskutoi, ndërsa theksoi se Palmer nuk kishte ardhur për t'i dhënë një zgjidhje konfliktit, "hallet tona", shtoi ajo "do të zgjidhen nga vetë shqiptarët me njëri-tjetrin". "Diskutoam për situatën dhe sigurisht që unë nuk jam e autorizuar që të flas për takimin. Z. Palmer shprehu opsionet e veta nga këndvështrimet e tij. Sigurisht që përputhen për sa i përket raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për luftën kundër korrupsionit, për kapjen e shtetit, për të gjithë problemet e tjera, por është shumë e rëndësishme vazhdimi i mëtejshëm për zgjedhjen përfundimtare dhe për t'i dhënë fund tranzicionit shqiptar. Shqipëria e ka vendin në BE", tha kryetaria e LSI-së. Sipas saj: "Palmer nuk kishte ardhur për t'i dhënë zgjidhje për sa i përket konfliktit. Mos harroni që hallet tona do t'i zgjidhim ne shqiptarët vetëm me njëri-tjetrin. Sigurisht që mendoj që viktimat e gjithë kësaj historie, janë shqiptarët nuk është Kryeministri".



Zëvendësndihmësi Sekretari amerikan i Shtetit Matthew Palmer dhe kreu demokrat, Lulzim Basha dje në selinë e PD-së



Kryemadhi dhe zv/ambasadoria amerikane festojnë ditëlindjen në një ditë

Kryetaria e LSI, Moni ka Kryemadhi festoi dje ditëlindjen e 45-të të saj. Në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin vit, ka lindur edhe zv/ambasadoria amerikane në Tiranë, Levya Moses-One, e cila zgjodhi të festojë me Kryemadhin këtë ditë të veçantë. Dy zonjat kanë lindur më 9 prill 1974. Pas takimit të zhvilluar në selinë e Lëvizjes Socialiste për Integritim, Moses doli nga selia me një tuftë lule, të cilën ia ka dhuruar Kryemadhi me rastin e ditëlindjes. Lëvizja Rinore për Integritim ka zgjedhur një mënyrë krejt origjinale për të urrear dje me rastin e ditëlindjes. Kryetaren e LSI Monika Kryemadhi. Një tortë, e cila tregon flamurin e Bashkimit Europian në brendësi të të cilit ngrihet një shtëpi me ngjyrën e kuqe të flamurit kombëtar dhe mbi të cilën qëndron shqiponja e zezë dykrenare. Në tortë binte në sy mbishkrimi "Me ty do ta bëjmë Shqipërinë shtëpinë tonë", një mesazh besimi i të rinjve të LSI për drejtuesen e partisë.



Zyrtari i lartë amerikan: Nuk është zgjidhje djegia e mandateve, fatkeqësi nëse opozita bojkoton

SHBA, Palmer: Qeveria legjitime, opozita të hyjë në zgjedhje

"Opozita të bindë elektoratin që të vijë në pushtet"

Valentina Madani

Vizita e zëvendësndihmës Sekretarit Amerikan të Shtetit Matthew Palmer, nuk kishte si qëllim nisjen e negociatave mes partive politike në Shqipëri. Palmer deklaroi dje se në Tiranë nuk e ka sjellë kriza politike dhe negociimi i saj nuk ka qenë pjesë e axhendës së tij 2 ditore. Në një takim me gazetarët ai e vuri theksin te bashkëpunimi mes vendeve dhe theforcimi i luftës ndaj korrupsionit. Ai u kujdes të saktësoi se nuk ka ardhur në Tiranë me një platformë për zgjidhjen e krizës. "Nuk jam këtu për të negociuar një platformë me palët", tha z.Palmer, deklaroi z.Palmer. Zyrtari i lartë amerikan ishte i prerë me opozitën duke kërkuar pjesëmarrjen e saj në zgjedhjet e qershorit. Ai dënoi djegien e mandateve ndërsa theksoi se opozita duhet të vijë në pushtet vetëm përmes rrugëve demokratike. I pyetur për mesazhin që ka për palët, ai deklaroi se të gjitha partitë duhet të futen në zgjedhjet e 30 qershorit dhe veçanërisht opozita duhet të gjejë një rrugë për t'u bërë pjesë e tyre.



Zëvendësndihmës Sekretari amerikan i Shtetit Matthew Palmer

MANDATET

"Nuk është zgjidhje djegia e mandateve nga opozita, duhet të gjej një mënyrë për të marr pjesë në zgjedhje. Do të ishte fatkeqësi nëse opozita nuk do të merrte pjesë në këtë proces demokratik. Përgjegjësi e opozitës është të marrë pjesë në zgjedhjet e qershorit dhe të ndaj vizionin e saj me mbështetësit dhe të punojë fort për t'i fituar zgjedhjet", tha z.Palmer.

NEGOCIATAT

"Nuk jam këtu për të negociuar një platformë me palët. Të gjitha partitë duhet të marrin pjesë në zgjedhje dhe duhet të punojnë fort për to dhe procesin politik. Opozita duhet të gjejë një mënyrë për të marrë pjesë në zgjedhje dhe në inkurajojmë këtë", tha i dërguari i SHBA në Tiranë.

QEVERIA

"Shqipëria ka një qeveri legjitime me të cilën ne bashkëpunojmë. Vendi juaj është aleat i yni dhe qeveria juaj do të ketë mbështetjen tonë. Jam konfident se kjo qeveri do të çojë vendin përpara dhe do të vazhdojë me zbatimin e reformave si ajo në drejtësi", -theksoi z.Palmer.



"Krizja mund të ndikojë në vendimin e Brukselit"

Italia, Cuttillo: Të nisë dialogu, mazhoranca të bëjë një hap pas

Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Alberto Cuttillo ka folur për situatën politike në vend ndërsa tha se djegia e mandateve nga ana e opozitës i ka surprizuar. Cuttillo gjatë fjalës së tij shtoi se mazhoranca duhet të bëjë një hap pas dhe se kriza politike mund të ndikojë në vendimin e Brukselit. "Djegia e mandateve na ka surprizuar. Mazhoranca duhet të bëjë një hap pas. Kriza politike mund të ndikojë në vendimin e Brukselit për hapjen e negociatave", theksoi ambasadori i Italisë në vendin tonë. Cuttillo përmendi se: "Pikëpyetja e parë është sa i përket vendimit të opozitës që të braktisë parlamentin, se ky është një vendim i paprecedentë dhe po krijon këtë situatë dhe po lë me gojë hapur të gjithë. Mund të ketë një efekt negativ politik, por gjithsesi vendimi do të merrret në qershor dhe që Italia shpreson të hapen negociatat". Kjo deklaratë u bë gjatë një takimi me investitorët të huaj në sektorin energjetik. Ambasadori theksoi se për shkak të situatës politike, ky takim punë u shty për sot, pasi shumë investitorëve preferuan të mos merrnin pjesë për shkak se në datën e planifikuar, zhvillohej protesta e opozitës. Cuttillo i kërkoi sërish opozitës që protestat të jenë paqësore. Ai tha se, duhet të nisë dialogu mes forcave politike duke theksuar që "dialog nuk do të thotë që të pranohen kushtet e opozitës, por të bisedohet për të arritur qëllimet për integrimin e vendit në BE".

z.Palmer: **QEVERIA**

Matthew Palmer gjatë një takimi që ai zhvilloi me një grup gazetarësh në Tiranë, ku ai gjendet si pjesë e një turi ballkanik e cilësoi legjitimitet qeverinë teksa vlerësoi përpjekjet e saj për reformat e ndërmarra. zv./ndihmës Sekretari Amerikan i Shtetit për Euroazinë garanoi se qeveria është legjitime dhe do të ketë mbështetjen e Washingtonit. "Shqipëria ka një qeveri legjitime me të cilën ne bash-

këpunojmë. Vendi juaj është aleat i yni dhe qeveria juaj do të ketë mbështetjen tonë. Jam konfident se kjo qeveri do të çojë vendin përpara dhe do të vazhdojë me zbatimin e reformave si ajo në drejtësi", -eklaroi z.Palmer.

LOBIMI

Zëvendësndihmës Sekretari i Shtetit Matthew Palmer nuk komentoi gjatë çështjet e lobimit të Partisë Demokratike, duke ripërsëritur se kjo procedurë është e ligjshme në SHBA, për sa kohë është në përputhje me

të gjitha ligjet dhe respektohen të gjitha rregullat. Sipas tij ligji është i qartë për "rregullat që ndiqen". Për dëshimtet se Partia Demokratike ka lobuar kundër kandidatës për ambasadore të SHBA në Shqipëri, Kathleen Ann Kavalec, zyrtari i lartë amerikan deklaroi se "çështja është nën hetim". I pyetur drejtpërdrejt për rrëzimin e kandidaturës për ambasadore në Tiranë Kathleen Ann Kavalec nga Presidenti Trump, Palmer u shpreh i rezervuar për të dhënë arsye, por bëri të ditur se shumë shpejt do të ketë një emër të ri për diplomatin që do të përfaqësojë Shtetet e Bashkuara në vendin tonë. Palmer u pyet edhe për influencën ruse në Shqipëri dhe thotë se Moskë nuk e ka të lehtë në tentativën e saj. "Shqipëria është target i vështirë për Rusinë", deklaroi z.Palmer.

KOSOVA

Në fokus të diskutimit gati një orë me gazetarët ishin edhe marrëdhëniet Serbi-Kosovë, ku Palmer tha se nevojitet një marrëveshje mes palëve. Palmer ripërsëriti qëndrimin amerikan për një marrëveshje që sjell njohje reciproke, ku mund të përfshihet edhe korrigjimi i kufijve. "Ne e mbështesim një marrëveshje mes dy vendeve për sa kohë ato bien dakord për një pakt ku tregohen interesat e tyre. Çështja e kufijve jo në qendër të kësaj marrëveshje", u shpreh zyrtari i lartë i SHBA-ve.

Meta me presidentin e OSBE: Reflektim, të përfaqësojmë vlerat më të mira

Takim shumë konstruktiv e ka quajtur presidenti i vendit, Ilir Meta, takimin me Presidentin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, George Tsereteli dhe Sekretarin e Përgjithshëm të saj, Roberto Montella. Me një shënime në faqen e tij në FB, teksa poston edhe një foto shkrepur gjatë bisedës, Meta thekson se "Shqipëria duhet të reflektojë dhe përfaqësojë vlerat dhe parimet më të mira të OSBE". "Takim shumë konstruktiv me Presidentin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, George Tsereteli dhe Sekretarin e Përgjithshëm të saj, Roberto Montella. Kryesimi i radhës i OSBE-së nga Shqipëria në vitin 2020 është përgjegjësi dhe arritje e madhe. Shqipëria duhet të



OSBE-së, George Tsereteli dhe Sekretarin e Përgjithshëm të saj, Roberto Montella. Kryesimi i radhës i OSBE-së nga Shqipëria në vitin 2020 është përgjegjësi dhe arritje e madhe. Shqipëria duhet të

reflektojë dhe përfaqësojë vlerat dhe parimet më të mira të OSBE. Kemi besim tek mbështetja dhe bashkëpunimi i Asamblesë Parlamentare të OSBE", -shpreh z.Meta.

**REFORMA
DIPLOMACIA**

Drejtesi i emisioni "Të paeksportuarit" kërkoi proces të hapur

"Kadrinj e gjobaxhinj" Rakipi kundër, padit Ramën për cenim imazhi



ata që Rama i quan PPP. Në këtë pikëpamje, unë dua t'ju them ju, që kjo është një padi e ngritur nga vetë regjimi, ky është një regjim. Është një regjim që ndryshon në

formë. Nuk kemi më regjime të Adolf Hitlerit apo regjimet e Enver Hoxhës. Regjimet e reja janë kur ato të privojnë të gjitha liritë, janë regjime kur nuk mundesh të bësh asgjë", - tha Rakipi. Më tej duke denoncuar rreptëkjet e qeverisë për të goditur çdo zë që përpiqet të jetë i lirë, Rakipi ka kërkuar që zhvillimi i procesit gjyqësor për kundërpadimë që ai ka paraqitur duhet të jetë i hapur. "Unë dua t'ju them që kundërpadimë që i kam bërë Ramës, kur të vijojë procesi gjyqësor, ai të vijojë me dyer të hapura dhe gazetarët ta ndjekin atë

si proces ku ne do të shohim se kush është njeriu që fyen dinjitetin dhe personalitetin e njerëzve që në këtë rast, në këtë rol është kryeministri Edi Rama. Unë besoj se në atë paditë që ka bërë Rama për mua, vetëm ndonjë gjykatë e Rexhep Tajip Erdoganit mund të më dënojë. Unë jam i bindur në drejtësinë e gjykatës, sado probleme që kanë sot gjyqtarët shqiptarë, të vënë përballë presioneve të vetingut apo presioneve të tjera të qeverisë Rama, sikundërse pushtetit tonë", -tha Rakipi.



Gjatë një seance parlamentare

Nga ish-deputetë e gjykatës tek truporjat e shoferët me pasaporta diplomatike

Cakaj: Hiqen 350 pasaporta diplomatike të paligjshme

"Do të bllokohet dhe do të shpallet e pavlefshme"

Ministri i Jashtëm në detyrë ka ndër marrë një tjetër masë të fortë në kuadër të disiplinimit të shërbimit diplomatik dhe punëve në këtë ministri. Pasi hoqi targa "CD" për të gjithë konsujt e ndër të shërbejnë në vendin tonë, shkarkimit dhe lëvizjes nga detyra të më shumë se 28 diplomatëve, ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj ka marrë një tjetër vendim të fortë. Bëhet fjalë për heqjen e të gjithë pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të dhëna në mënyrë të pamrituara funksionarëve dhe personave të ndryshëm. Lajmin e heqjes së pasaportave diplomatike dhe atyre të shërbimit e ka bërë të ditur vetë Cakaj gjatë një daljeje të posaçme për mediat, ku theksoi se një numër i konsiderueshëm individësh në vendin tonë mbajnë pasaporta diplomatike dhe shërbimi në kundërshtim të plotë me ligjin. "Shqipëria ka dyfishin e pasaportave diplomatike krahasuar me vendet e fuqishme evropiane. Kjo nuk është një krahasim për qëllime stilistike, por ky është një fakt. Në shkelje flagrante edhe të këtij kuadri ligjor dhe administrativ sot në Shqipëri ka më shumë se 350 persona që



Ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj

mbajnë pasaportë diplomatike në shpërputhje me ligjin, që hyjnë e dalin si personalitete me status të veçantë. Deputetë të mandatave të kaluara, gjykatës që nuk e kanë kaluar vetingun, deri tek shoqërues të personaliteteve të njohura në Shqipëri", - tha Cakaj. Ai e përshkroi këtë vendim si një tjetër përpjekje për të sjellë drejt normalitetit shërbimin diplomatik shqiptar, ndërsa i ftoi ata që t'i dorëzojnë vetë këto pasaporta. "I ftoj publikisht të gjithë të bëjnë dorëzimin e pasaportave diplomatike, sepse pasaporta e tyre diplomatike do të bllokohet dhe do të shpallet e pavlefshme", - shtoi Cakaj. Më tej ai tha se një grup pune po përgatit ma-

teriallet e nevojshme për të kërkuar shfuqizimin e VKM-së përkatëse, më pas një plan rregullues do të kalojë në parlament. "Këto janë çudira që kanë vazhduar për 20 vite dhe kanë cenuar rëndë besueshmërinë e pasaportës shqiptare në sistemin ndërkombëtar të pasaportave diplomatike. Rrjedhojë e kësaj besueshmërie të barabartë me zero është

edhe hezitimi, por edhe refuzimi i shumë vendeve evropiane dhe më gjerë për të liberalizuar reciprokisht lëvizjen e bartësve të pasaportës diplomatike, e si mund të flasim pastaj për liberalizimin e pasaportave të zakonshme. Unë do t'i përcjell qeverisë për vendim abrogimin e VKM-së që i jep të drejtën e pasaportës diplomatike drejtuesve të anëtarëve të bordeve, udhëheqësve të enteve e autoriteteve të ndryshme rregullatore deri tek shoferët e institucioneve të caktuara. Plani i veprimit për ndryshimin e kuadrit ligjor dhe administrativ për lëshimin e pasaportës diplomatike është gati dhe është në përputhje me standardet me rigorozë evropiane për bartjen e pasaportës diplomatike", - theksoi ministri i Jashtëm në detyrë. Në gati 3 javët e fundit Cakaj ka ndër marrë një reformë të gjerë në Ministrinë e Jashtëm.

SHKURTE

Spiropali: Opozita doli nga Kuvendi që të prishë imazhin e vendit

Ministria për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali nga studioja e "News 24" akuzoi opozitën se u largua nga Kuvendi për të krijuar një imazh negativ të vendit, në një kohë kur Shqipëria pret çeljen e negociatave. Ajo tha se shqiptarët i kanë besuar qeverisjen e vendit Partisë Socialiste, ndërsa pohoi se asnjë dhunë apo presion nuk e pengon qeverisjen e Edi Ramës. Gjithashtu Elisa Spiropali nënvizoi faktin se dalja e opozitës në rrugë ka për qëllim të frenojë reformën në drejtësi, por edhe pengimin në hapjen e negociatave. E para, i gjithë aksioni opozitar synon që të cenohet çeljen e negociatave, me pretendimin se çelja e negociatave është një dorë për qeverinë, por, në fakt, kjo është një e mirë që do të prekë të gjithë shqiptarët. E dyta, opozita nxin imazhin e vendit në mediat ndërkombëtare. Zgjedhjet lokale po afrojnë dhe sigurisht ata shohin sondazhet, si Bashha dhe si Kryemadhi nuk kanë arritur të bëjnë një program dhe një alternativë për t'iu kërkuar votën shqiptarëve. E treta, reforma në drejtësi ka shkaktuar shumë pagjumësi në radhët e opozitës. Në nuk i dimë arsye, ata i dinë më mirë", -tha Spiropali.

PD: Një drejtësi e pakapur do të hetonte gjithë Rilindjen

Zëdhënësja e PD-së, Ina Zhupa iu kundërpërgjigj dhe ministres së Marrëdhënies me Parlamentin, Elisa Spiropali, e cila deklaroi se opozita e ka lëshuar Kuvendin për shkak se s'ka ekip. Zhupa e quan Spiropalin "zonja 5 milionë euro", ndërsa theksoi se një drejtësi e pakapur do kishte marrë në hetim Rilindjen të parën, pastaj me radhë gjithë organizatën e Elisë. "Zonja 5 milionë euro e doganave sapo renditi në tv, 3 arsye pse opozita ka dalë nga parlamenti sipas saj. S'ka ekip dhe program tha Elisa. Në fakt, këta ekip të mirë konsiderojnë vetëm trafikantë droge, përdhunues, trafikantë femrash apo abuzues me fondet publike si vetë zonja në fjalë. Sondazhet e nxjerrin keq tha Elisa. S'po i referohem fare sondazheve të brendshme, por mjafton të shohin ato publike, të cilat e nxjerrin opozitën fituese të zgjedhjeve. Opozita paska frikë nga reforma në drejtësi vuri pikën zonja e doganave", tha znj.Zhupa.

Shoqëria perbarimorë JUSTITIA

Shoqëria perbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë , për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vene hipoteke ALPHA BANK, me këto të dhëna:

Apartament me nr.pas.7/21+1-4 , z.k.8360, vol.26 , fq. 204, me sip 138.40 m2, Rruga "Zenei Baboci" Tiranë, në pronësi të z.Gentian Kutjim TOSKU.

Në vlerën 124.006 Euro (njëqind e njëzetë e katër mijë e gjashtë eur).

Ankandi zhvillohet në datën 23.04.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adrese Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Sh.k. 3, Ap. 18, Tiranë.

Nga ana e Shoqerisë "Shërbimi Perbarimorë AB" Shpk është shpallur ankandi faza e parë për pasuritë e mëposhtme:

1. "Trulli-Hidresis" me sipërfaqe truall 1328 m2 (në mijë e treqind e njëzet e tetë) dhe sipërfaqe ndërtese 508 m2 (peseqind e tetë) me Nr.Pasurie 691/31 në Zonën Kadastrale 1167, Vëllimi 8, Faqe 94 me adresë Komuna Borçullë, Tiranë.

Cmimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 881.600 (steqind e tetëdhjetë e një mijë gjashtëqind)Euro.

2. "Trulli-Hidresis" me sipërfaqe truall 3761 m2 (tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) dhe sipërfaqe ndërtese 1818 m2 (në mijë e tetëqind e tetëdhjetë) me Nr.Pasurie 691/30 në Zonën Kadastrale 1167, Vëllimi 8, Faqe 93 me adresë Komuna Borçullë, Tiranë.

Cmimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 1.280.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) Euro.

Ankandi do të zhvillohet në datë 23.04.2019 në orën 16:30 pranë zyrës së shoqerisë "Shërbimi Perbarimorë AB" Shpk me Përbërues Gjyqësor Privat Admni Boqiri në ndodhur në adresën Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.1.Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tiranë.



Dy kandidatë të tjerë tradhtojnë PD dhe LSI, dorëzojnë formularët e dekriminalizimit

KQZ i jep mandatin dy deputetëve të rinj, opozita e re me 23 anëtarë

PSD dhe PLDE regjistrohen për zgjedhjet e 30 qershorit

Opozita e re në Kuvend është shtuar edhe me dy anëtarë të rinj. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dhënë mandatin dy kandidatëve të Partisë Demokratike të Qarkut Dibër dhe Qarkun Korçë. Bëhet fjalë për kandidatët PD-së në listën shumëmërore të Qarkut Dibër Halil Jakimi dhe Arlind Çaçani po nga lista shumëmërore e PD-së në Korçë. Të dy ata pritet të betohen ditën e enjte në seancë plenare dhe së bashku me ta Kuvendi shkon në numrin e përgjithshëm të anëtarëve në 102, nga të cilët 23 vijnë si përfaqësues të opozitës së re parlamentare. Por ky numër pritet të rritet edhe më tej, pasi të tjera rrjedhje kanë ndodhur nga listat shumëmërore të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim. Dy kandidatë të tjerë kanë pranuar të marrin mandatin e deputetit, pasi kanë dorëzuar formularin e vetëdeklarimit të dekriminalizimit pranë Komisionit Qendror Zgjedhor. Ata janë Andi Përmeti, anëtar i kryesisë së FRPD dhe Eugen Bojaxhi nga radhët e LSI, i cili ka garuar në zgjedhjet e shkuara në listën e qarkut të Beratit.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kandidatët
Dy kandidatë të tjerë kanë pranuar të marrin mandatin e deputetit, pasi kanë dorëzuar formularin e vetëdeklarimit të dekriminalizimit pranë Komisionit Qendror Zgjedhor. Ata janë Andi Përmeti, anëtar i kryesisë së FRPD dhe Eugen Bojaxhi nga radhët e LSI, i cili ka garuar në zgjedhjet e shkuara në listën e qarkut të Beratit.

ara deri më tani nga KQZ, ndërsa në pritje është edhe miratimi i kërkesës së Partisë Socialiste. PS e dorëzoi kërkesën për regjistrim dy ditë më parë, nëpërmjet një shkrese që mbante firmën e Blerina Gjylmetit. Më përpara KQZ ka regjistruar me vendim komisioni 11 parti, ndërmyet të cilave: Partia e të Drejtave të Mohuara Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve, Partia e Personave me Afësi me të Kufizuara, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Socialiste e Moderuar, Partia Unite Kombëtar, Partia Kristian Demokratike, Partia Aleanca Demokratike dhe Partia e Gjelbër. Por pavarësisht përjekjeve të PS të nxitur partitë e tjera që të regjistrohen, deri më tani asnjë forcë politike kryesore nga kampi opozitar nuk ka paraqitur kërkesë në KQZ. Ato deri më tani kanë injoruar detyrimet që përcakton Kodi Zgjedhor, duke mos përmbyshur asnjë detyrim. Kështu PD dhe LSI jo vetëm që nuk janë regjistruar (për këtë nuk mund t'i akuzosh se kanë ende kohë ligjore), por nuk kanë paraqitur as kandidatë për anëtarë të komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë, KZAZ. 21 prilli është afati i fundit për regjistrimin e partive politike në KQZ, ndërsa 10 ditë më pas përfundon afati për regjistrimin e koalicioneve.

Balla: Procesi i anëtarësimit në BE, investim për paqe në rajon

Konferenca e 28 kryetarëve të Parlamenteve të Vendeve Anëtare të BE mbështet vijimin e procesit të anëtarësimit për vendet e Ballkanit Perëndimor. Lajmin e ka dhënë kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla pas takimit që u zhvillua në Vjenë ku kryefjalë e diskutimeve ishte zgjerimi i Bashkimit Europian me vendet e Ballkanit Perëndimor. Balla tha se 28 kryetarët e parlamenteve të vendeve anëtare të BE-së, nënvizuan rëndësinë e hedhjes së hapave konkretë për secilin nga vendet e BE, përfshi këtu Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut. "Pas mbështetjes së Parlamentit Europian, vlerësimit të Komisionerit Hahn se në fund të majit progresi i hedhur deri tani nga Shqipëria, janë edhe 28 kryetarët e parlamenteve të vendeve anëtare të BE-së, të cilët shprehin qartë mbështetjen në drejtim të vijimit të procesit të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit perëndimor në BE. Nënvizojnë rëndësinë e hedhjes së hapave konkretë për secilin nga vendet e BE dhe këtu nënvizojnë rëndësinë që ka për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut fillimi i bisedimeve për anëtarësim në qershor, sepse do të jetë Këshilli Europian ai që do të hapë dritën jeshile për këtë vijim të procesit. Ajo që është shumë e rëndësishme dhe që u diskutua gjerësisht në këtë takim është pikërisht rritja e ndikimit të aktorëve të jashtëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor e në mënyrë të veçantë të Rusisë dhe në këtë kontekst iu kërkua BE-së të luajë një rol më adekuat për të ruajtur vlerat e veta në Ballkanin Perëndimor, por edhe duke vijuar me procesin e anëtarësimit, duke vëqar me procesin e anëtarësimit si një investim për paqe, siguri dhe stabilitet në rajon" - u shpreh Balla.

Opozita nuk paraqiti emrat, KQZ ngre KZAZ me qytetarë jopolitikë

KQZ vendosi dje edhe ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019. Pavarësisht se partitë opozitare nuk e ushtruan të drejtën e tyre për të dorëzuar emrat e komisionerëve, KQZ i ka plotësuar ato me qytetarë të ndryshëm që kanë aplikuar për të qenë komisionerë. Deri më tanë mësohet se 324 shtetas kanë aplikuar për sekretarë dhe anëtarë të KZAZ në rrethet prej të cilëve 160 janë me profesion juristë. Vendet për sekretarë dhe anëtarë nuk janë plotësuar ende në 6 KZAZ të Bashkive Fushë-Krujë, Shijak, Durrës, Roskovec, Himarë dhe Dropull. Mbledhja e parë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, do të zhvillohet ditën e enjte dhe ditën e premte, datë 11 dhe 12 prill 2019, ora 10.00 në Sellitë e KZAZ-ve.



SHPALLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 26.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i l-rë për shiten e pasurive të palajshme në pronësi të Z. Shpëtim Barjam Boci:

- Trulli me sipërfaqe 2863 m², Nr.pasurie 88/16, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 107 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 68,712 (Gjasthëdhjet e tetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) EURO
- Trulli me sipërfaqe 2317 m², Nr.pasurie 88/25, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 121 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 55,608 (Pesëdhjet e pesë mijë e gjashtëqind e tetë) EURO
- Trulli me sipërfaqe 790 m², Nr.pasurie 88/23, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 119 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 18,960 (Tetëmbëdhjet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) EURO
- Trulli me sipërfaqe 780 m², Nr.pasurie 88/20, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 111 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 18,720 (Tetëmbëdhjet mijë e shtatëqind e njëzet) EURO
- Trulli me sipërfaqe 1750 m², Nr.pasurie 88/18, Zona Kadastrale nr.2007, Volumni 9, Faqe 109 ndodhur në Jorgucat Gjrokastrë, me vlerë fillestare në ankan 42,000 (Dyzet e dy mijë) EURO

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

PRIMALL

Rr.Ibrahim Rugova
Pallati Kontakt nr.10, Kati 4
1000 Tirana, Albania
t. +355 44 500 909
f. +355 44 500 910

info@primall.al www.primall.al

Shoqëria **PRIMALL shpk**, distributor i autorizuar për Shqipërinë e markave të kompanisë ndërkombëtare "JT International", njofton mbi cmimin e produktit të ri që do të tregohet duke filluar nga data **15/04/2019** i cili është si me poshte

Marka	Cmimi perfundimtar me date 15 Prill (TVSH e përfshirë)
Winston XStyle Silver Long	230

Njoftimi behet ne perputhje me udhezimin Nr.6 date 30/01/2015 te Ministrise se Financave "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar)

PROJEKTI I BULEVARDIT PERPLASJET



76-vjeçari i plagosur,
Uzur Mandri



Banorët e Bregut të Lumit
gjatë rezistencës së djeshme



Përplasje e djeshme mes
banorëve të Bregut të
Lumit dhe policisë

Aksioni për zgjerimin e bulevardit, përplasje fizike mes tyre

Shemben 7 shtëpi te Bregu i Lumit, 4 banorë e tre policë në spital

"Përdorën gaz lotsjellës për të na larguar"

Shemben 7 shtëpi në Bregun e Lumit, ndër sa procesi u shoqërua me dhunë e përplasje mes banorëve e policisë. Banorët bënë rezistencë për të mos iu shembur shtëpitë ndërsa nga policia u përdor gaz lotsjellës për t'i nxjerrë ata jashtë. Të paktën kështu u raportua nga gazetarët që ndoqën situatën. Sipas banorëve, 38 banesa u përjashtuan nga skema e dëmshpërblimit, ndërsa bashkia pretendon se ata nuk kanë asnjë dokument dhe kanë ndërtuar pa leje. Atyre i është ofruar vetëm bonus qiraje dhe hapësirë për kredimarrje të butë ose banesa sociale. Pjesa tjetër e banorëve kërkojnë dëmshpërblimin para se të kryhen punimet. Këto janë dy grupimet që bëjnë rezistencë për mosshëmbjen e shtëpive, të cilat do i japin drejtim, fillimit të punimeve për zgjerimin e bulevardit të ri.

TË PLAGOSURIT
Të paktën tre punonjës policie e katër banorë kanë mbetur të plagosur nga përplasia te Bregu i Lumit. Tre qytetarë që kanë pasur nevojë për ndihmë mjekësore janë, 76-vjeçari Uzur Mandri, i cili u çua në kokë e kishte nevojë për qepje, Flora Mandri dhe Xhabir Boleci. Situa-ta e nxehtë vijoi deri sa policia përdori gazin lotsjellës për të larguar banorët e irrituar ndërsa shembën 7 shtëpitë e para, ndërsa ditët në vijim mbeten edhe 31 shtëpi të tjera për t'u rrafshuar. "Sna bënë legalizimin, na e refuzuan, tani thonë dilni nga shtëpia. Ku të shkojmë ne, me fëmijë të vegjël", thotë një banorë e shtëpive që preken nga pro-



Flora Mandri në Spitalin Ushtarak

Dëshmia e gruas nga Spitali Ushtarak: U përdor gaz

Flora Mandri: Kam fraktura në këmbë dhe në trup, na dhunuan policët

Flora Mandri është një nga gratë që është nxjerrë me dhunë nga shtëpia e saj te Bregu i Lumit mëngjesin e sotëm. E sh-truar në Spitalin Ushtarak me fraktura në këmbë dhe trup, Flora është takuar nga afër prej ish-deputetit të PD-së, Klevis Balliu, të cilit i ka treguar se policia ka hedhur edhe gaz lotsjellës për t'i shpërndarë. "Na kanë hedhur gaz në kohën që na kanë marrë



neve në polici lart. Atëherë e kanë hedhur gazin. Unë kam dhimbje të madhe për Zotin", - dëgjohej të thotë ajo në një video të shpërndarë nga Partia Demokratike. Gjatë të hënës e të martës, banorët e Bregut të Lumit në Tiranë janë përplasur fizikisht me forcat e policisë. Ata kundërshtojnë me çdo mjet prishjen e banesave të tyre, ndërsa kërkojnë dëmshpërblim financiar sipas ligjit në fuqi.

jekti i bashkisë. Shtëpitë që u shembën ishin vila disa katëshe të ndërtuara në fillim viteve '90.

VIDEOET
Partia Demokratike ka

shpërndarë disa video ku mëngjesin e djeshëm, forca të shumta policie zbarkuan në zonë bashkë me fadromat. Aty shihet qartë momenti kur gazi përhapet mbi sh-

tëpitë e Bregut të Lumit. PD pretendon, gjithashtu, se gazi është hedhur që në orën 06:00 të mëngjesit për t'i nxjerrë banorët nga shtëpitë e për të vijuar prishja e bane-



Forcat Speciale në ndihmë të policisë te Bregu i Lumit

Në ndihmë të policisë kanë shkuar në zonën e Bregut të Lumit edhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë. Nëse do të ishte e nevojshme ata do të ndërhyjnë për të nxjerrë me forcë banorët që ndodheshin brenda shtëpive të tyre e që janë parashikuar për t'u shembur, si rezultat i projektit për zgjerimin e Bulevardit të Ri. Forcat e policisë siguruan gjithë zonën që u rrethua për t'u shembur dhe nuk lejuan askënd të lëvizte brenda zonës së sigurisë. Disa banorë që u janë shembur shtëpitë u shoqëruan për veprën penale "kundërshtim të policisë".

save me fadroma. Një video e dytë u postua nga PD ku shihet një i moshuar i mbuluar me gjak në fytyrë, ndërsa u pretendua të ishte dhunuar nga policia gjatë rezistencës për të mos lejuar prishjen e shtëpisë. Gazetarja Dorjana Bezat bëri me dije për "Gazeta Shqiptare" se bëhet fjalë për 76-vjeçarin Uzur Mandri,



Edhe "Astiri" i bashkohet protestës së banorëve

Me thirrjet "Rama ik, Rama ik" dhe "Shtëpitë tona do t'i mbrojmë me gjak", banorët e Bregut të Lumit vijojnë protestën prej dy ditësh. Me ta, të martën u solidarizuan edhe protestuesit e Unazës së Re, që kanë të njëjtin hall. 38 banesa në zonën e Bregut të Lumit ku pritet të zgjerohet Bulevardi i Ri i Tiranës janë përjashtuar nga skema e dëmshpërblimit dhe iu është ndërprerë procesi i legalizimit. "Dola në mbrojtje të shtëpisë sime, dy policë më ranë me grushte. Shtëpia ime është në proces legalizimi si 240 të tjera që janë shpronësuar tashmë", - tregoi njëra nga protestueset.

i cili bëri dhe një ndërhyrje kirurgjikale. Në të njëjtën video, duket edhe momenti kur policia ka ndërhyrë në zonë, e disa banorë i janë përgjigjur duke hedhur tje-gulla në drejtim të tyre. Po ashtu raportohet se në komisarariat nr.4 të policisë qëndrojnë 6 banorë të tjerë të ndaluar nga policia.



Presidenti i kërkon Avokatit të Popullit të ndërhyjë

Meta: Të hetohet dhuna e ushtruar nga policia

"Bregu i Lumit, prokuroria të nisë verifikimet"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, ka reaguar ashpër ndaj qeverisë dhe Bashkisë së Tiranës lidhur me situatën konfliktuale të dy ditëve të fundit të krijuar në Tiranë për shkak të ndërhyrjes së autoriteteve publike për prishjen e banesave, me qëllim realizimin e projektit të zgjatimit të Bulevardit të Ri, në zonën e quajtur "Bregu i Lumit". Nëpërmjet zëdhënësit Blushi, Meta ka kërkuar ndër të tjera nisjen e menjëhershme të hetimeve për dhunën e ushtruar nga policia ndaj qytetarëve të pambrojtur.

DEKLARATA

"Përzgjedhja e kohës së ndërhyrjes për të nxjerrë qytetarët nga shtëpitë e tyre dhe mënyra e veprimit, duket një logjikë jo shtetërore, por tinzare dhe nuk reflekton asnjë mbështetje ligjore. Presidenti vlerëson se përdorimi i gazit lotshëlës duke detyruar banorët të dalin nga shtëpitë e tyre është një akt i papranueshëm" -thuhet në deklaratën e presidentit. Ai i bëri thirrje autoriteteve publike, Bashkisë Tiranë, Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, IKMT, IMT të Bashkisë Tiranë, që: Të tregojnë përgjegjshmëri në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, që gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe duhen domosdoshmërisht të mbrohen; Të zbatojnë me përpikmëri procedurat ligjore për shpronësimin për interes publik, të të gjithë personave që preken nga ky projekt, si të atyre që gëzojnë një certifikatë pronësie, por edhe të atyre që nuk kanë mundur të ligjërojnë dot banesat e ndërtaura edhe pse janë aty prej më se 20-vitesh; Presidenti i Republikës, vlerëson se realizimi i këtij projekti urban të rëndësishëm për qytetin e Tiranës, nuk duhet të pengohet dhe as të vonohet, por vënia në zbatim të tij, nuk duhet të shkatërrojë të ardhmen dhe jetën e shtresave më të pamundura të shoqërisë; Institucionet publike duhet të angazhohen për ta zgjidhur ligjërisht problemin dhe nëse një akt nënligjor që rregullon gjendjen nuk ekziston, ai mund të krijohet dhe të vihet në zbatim. Kjo është detyra primare e qeverisë, që brenda parashikimeve të ligjit dhe në respektim të parimeve, të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, duhet të mundësojë një zgjidhje-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

JORIDA TABAKU
Ish-deputetja e PD-së, Jorida Tabaku sulmon kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Përmes një postimi në "Facebook", Tabaku shprehet se Veliaj ushtron çdo ditë bullizëm ndaj atyre që nuk mendojnë njësoj me të. Tabaku publikoi, gjithashtu, edhe një video nga nisja e shembjes së shtëpive në Bregun e Lumit.

je të drejtë për të gjithë qytetarët dhe për interesin publik në tërësi; qeveria dhe Bashkia Tiranë duhet të tregojnë vullnet për zgjidhjen e këtij konflikti. Banorët kanë kërkuar dëmshpërbim për shtëpitë e tyre dhe nga konf-

likti që ka lindur rezultojnë se kërkesat e tyre nuk janë trajtuar në themel as nga Bashkia Tiranë dhe as nga qeveria. Në deklaratë shtohet se pavarësisht kush është forca që e drejton qeverinë ajo duhet t'i trajtojë qytetarët në

mënyrë të barabartë dhe t'i garantojë qytetarët e prekur nga realizimi i projekteve publike, të kenë mundësi të rifillojnë jetën e tyre me sa më pak dhimbje dhe kosto, që vijnë për shkak të humbjes së banesës së tyre.

PRESIDENTI

"Banorët kërkojnë dëmshpërbim për banesat e tyre pasi janë aty prej më se 20 vitesh dhe shteti, edhe pse e nje gjendjen prej vitesh, nuk mundet t'i trajtojë ata si zaptues, pasi çdokush meriton të drejtën për të pasur një strehë dhe për të rritur fëmijët e tij si gjithë të tjerët".



"Shtëpitë janë pa leje, ua kemi bërë ofertën"

Veliaj: Nuk do të lejojmë 'astirizimin' e shoqërisë

Kryebashkiaku Erion Veliaj u shpreh se nuk do të lejojë "astirizimin" e shoqërisë dhe se procesi i zgjerimit të bulevardit do të vijojë. "Sot ka nisur lirimi i brezit të parë të shtëpive. Do të vazhdojmë kështu çdo ditë. Në Tiranë nuk do të lejojmë 'astirizimin' e shoqërisë: kap një deputet budalla, gjej dhe nja dy media të politizuara, dhe mbaj gjithë shoqërinë peng. 99.99% e këtij qyteti do të ecë përpara, do që gjërat të bëhen me drejtësi dhe që taksat të përdoren me kujdes", deklaroi Veliaj, ndërsa theksoi se edhe për banorët që preken nga ky projekt dhe që kanë ndërtaur në gjurmën apo në shtratin e lumit do t'i ofrohet banesa sociale. "Pyetja është: i vajte ti lumit, apo erdhi lumi te ty? I vajte ti lumit! Ajo që kemi propozuar është: Kush ka ndërtaur në shtrat të lumit, aty ku përfundon bulevardi, do marrë banesë sociale. Pra, banesë për banesë. Janë shumë herë më të mira se ato që i merr lumi. Ama, t'u marrësh lekët e shkollave taksapagueseve, sepse kë ndërtaur pa leje në breg të lumit, nuk shkon. Edhe Sali Berisha që e shkatërroi këtë shtet, edhe ai nuk i përfshiu në VKM, që s'e kishte problem fare ta shkatërronte edhe më shumë. Por, kur edhe ai pati një limit të çmëndurisë së vet, do të thotë që ne të tjerët duhet ta kemi patjetër një limit. Shtëpi për shtëpi, asnjë njeri jashtë, asnjë njeri i pastrehë", sqaroi Veliaj.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 09 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

Nr	Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 09.04.2019 (përfshirë TVSh-në)
1	HEETS (AMBER LABEL)	320 Lekë/paketë
2	HEETS (BRONZE LABEL)	320 Lekë/paketë
3	HEETS (TURQUOISE LABEL)	320 Lekë/paketë
4	HEETS (YELLOW LABEL)	320 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar'" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

Agjencia Shtetërore e Kadastrës/ Zunë truallin pa leje, bëhen pronarë

Qeveria miratoi kalimin e të drejtën mbi pronësinë për parcelat ndërtimore ku janë ndërtuar objekte pa leje. Agjencia Shtetërore e Kadastrës publikon listën me 200 pronarë që marrin certifikatën e pronësisë. Përfuturit janë në Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Shëtesat, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. 'Gazeta Shqiptare' publikon listën e plotë me përfutuesit në të gjithë vendin.

VENDIMI

Këshilli i Ministrave vendosi në mbledhjen e fundit miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë, në favor të subjekteve përfutuese, për 200 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara, që preken prej tyre, sipas shpjegimit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Sipas ligjit në fuqi

Tapi për 200 familje, ja kush përfiton truallin

Përfutuesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë e Vlorë

nuk mund të legalizohet më shumë se 3-fishi i bazës së objektit të ndërtuar pa leje. Në rast se një person ka ndërtuar 50m2 do të marrësh 150 metra dhe kjo logjikë do të ndiqet për të gjitha ndërtimet. Objektet tregtare që kanë bërë ndërtime p.sh., 500

metra do të marrin 1500 metra, por do ta paguajnë me çmim tregu. Ndërsa për llogaritjen e vlerës së parcelës është marrë gjysma e vlerës së tregut.

KALIMI I PRONËSISË

Në vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohet që

kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje bëhet sipas dispozitivave të Kodit Civil. Në rastin e ndërtimeve me funksion banimi, si rregull sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë duhet të jetë deri

në masën e trefshit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m². Për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik zbatohet vetëm kriteri i trefshit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit. Kur për shkak të përmasave

LIGJI

Sipas ligjit në fuqi nuk mund të legalizohet më shumë se 3-fishi i bazës së objektit të ndërtuar pa leje. Në rast se një person ka ndërtuar 50m2 do të marrësh 150 metra dhe kjo logjikë do të ndiqet për të gjitha ndërtimet.

ose konfiguracionit të parcelës ndërtimore krijohen sipërfaqe të lira, që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Lloji i objektit juridike (prones)
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit		
		ër	Numer	Date	

TIRANE JUG
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8380
KAMEZ-VORE

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _2066					TE TRETIVE (500 m ²)
NAIM	MET	PASHA	70209326	20.02.2018	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _2884					TE
NAZMI	RRAHMAN	HYSA	70209250	18.02.2018	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _1649					TRETIVE (500.5)
IMER	HALIL	HALMUSA			

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _1649					TE
SAIMI	IMER	HALMUSA	70208286	27.07.2018	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _1066					TE
VEHA	MET	TODAJ	70202102	15.02.2016	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _2884					TE
SKEN	RIZA	SELITA	70208215	21.07.2018	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8260					TE
ISUF	XHAFERR	POLES	20063	13.03.2012	

TIRANE SHËTESAT					TE
JORG O	NDONI	PRIFTI	120392	26.07.2018	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8260					TE
NIKOL L	MARK	NDOI	119116	16.06.2017	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8260					TE
FREDI	DEMIR	XHAFER AJ	119502	28.09.2017	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8260					TE
FASLL I	NJAZI	KORITA	120595	17.10.2018	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8260					TE
GELDON	GEZIM	TELA	118584	07.03.2017	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8260					TE
FREDERIK	PETRIKA	MUSHI	118677	27.03.2017	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8260					TE
HASIME	JONUZ	ÇELA	118676	27.03.2017	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8260					TE
ALBI	BESNIK	MUÇO			

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Lloji i objektit juridike (prones)
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit		
		ër	Numer	Date	

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8160

LIRAK	MUNTAZ	KODRA	120052	25.04.2018	
EVA	YZEIR	SEJDIA	120127	22.05.2018	
BARIJE	MALIO	NAJDENI			
KUJTIM XHEVDI ET	MERO	SHOSTIOLLARI	120053	25.04.2018	
IFETE	MEHMET	HAKCANI	120054	25.04.2018	
FIQIRI	SHYOYRI	HASIMJA	120055	25.04.2018	
FIQIRI	ALI	DUMI	120057	25.04.2018	
GAVRIL	THIMI	QIRJO	120056	25.04.2018	
KRIST	LLUKAN	DUSHI	119942	23.03.2018	
NAZMI	ALUSH	REXHEPI			

QARKU _TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE _8220

TAHIR	TAIP	KALEMAJ			
TAHIR	TAIP	KALEMAJ	119112	16.06.2017	
FANIJE	THOMA	HAMLLA	119007	23.05.2017	
LUTFIJE	MEHMET	KOÇI	119008	23.05.2017	
FATMIR	MEHMET	SHETA	119006	23.05.2017	
FLAMUR	SULEJMAN	DEMNERI			
TEUTA	SULEJMAN	GASHI (DEMNERI)			
MERITA	SULEJMAN	FAGU (DEMNERI)	119114	16.06.2017	
FLAMUR	SULEJMAN	DEMNERI	119054	05.06.2017	

VLORE

QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 2832, ZVRPP Vlorë

REIZ	MEZIN	KULL	212036	25.09.2018	Shtetëror
DERVI	MEZIN	KULL	212034	25.09.2018	Shtetëror
GURI	MEZIN	KULLURI	212035	25.09.2018	Shtetëror e (0)m ² E te

QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 8602, ZVRPP Vlorë

PATRIOT	SADIK	NURAJ	4983	16.02.2011	Shtetëror e (0)m ² E te tretteve (440.7) m ²
---------	-------	-------	------	------------	--

QARKU Vlorë, ZONA KADASTRALE 8605, ZVRPP Vlorë

RIZA	DEMIR	NANA	212207		Shtetëror e (0)m ² E te tretteve (500) m ²
					Shtetëror e (0)m ²

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Ojenj a juridike (prones)
Emër	Atësi	Mbiem ër	Leja e legalizimit		
			Numer	Date	
GURI	DEMIR	NANA	107478	21/10/2018 42951.00	Shtetëror e (0)m ² E te tretteve (500) m ²
ELBASAN					
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 3422					
ARDJ AN	MEHDI	KABAS HI	2579886	31.08.2018	PRON AR
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527					
LEZHE					
QARKU LEZHE, ZVRPP LEZHE, ZONA KADASTRALE 8632					
JAK	NDUE	MARKU	816912	27.06.2016	E te
MONDI	JAK	MARKU	817941	26.08.2016	E te
DURRES					
QARKU DURRES ZVRPP DURRES, ZONA KADASTRALE 3369					
EDM OND	ISLAM	ISAKU	223286	15.09.2016	PRONA R
ASTR IT	ISLAM	ISAKU	222656	06.09.2016	PRONA R
ARBE	KASEM	VORA	220020	12.07.2016	ME PRONA R
ISMET	KASEM	VORA			
BAJRA	KASEM	VORA			
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8515, ZVRPP DURRES					
PERP	NAZIF	HOXHA	242039	26.05.2016	ME
BASH	NAZIF	HOXHA	147097	29.02.2016	ME
QAMIL	TAIP	SPANESH	147088	11.02.2016	ME
SAIMI	NAZIF	HOXHA	152600	16.02.2016	ME
SELA	NAZIF	HOXHA	147096	31.03.2017	ME
QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8517, ZVRPP DURRES					
NDRE	PRENG	CUMRA	280027	25.07.2018	
YLBER	VESEL	ALUSHI	144827	27.05.2016	
YLBER	VESEL	ALUSHI	144827	27.05.2016	
SHKODER					
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 1495, ZVRPP SHKODER					
BASHKI	OAZIM	ÇOBAJ	93194	31.11.2015	
ARIF	OAZIM	ÇOBAJ	92742	16.02.2015	
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8591, ZVRPP SHKODER					
HAKI	HASAN	FASLUJA	18770	30.06.2017	
HASA N	MUSA	RAMJA	18769	20.07.2016	
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8593, ZVRPP SHKODER					
FRAN G	GJON	LEKAJ	10221	02.05.2012	
LAZE	KOL	GJEKAJ	10005	26.04.2012	
NDOC	NDUE	LEKAJ	11022	14.05.2012	
GJON	RAKE	DOÇAJ	19591	29.07.2016	
GJON	MARASH	KOLAJ	19583	13.10.2015	
KUJTI M	ZEF	VUKAJ	19584	27.12.2018	
LULE	SOKOL	GJELAJ	94803	10.05.2016	
QARKU SHKODER, ZONA KADASTRALE 8597, ZVRPP SHKODER					
NDOC	KOLE	BJESHK A	102231	30.03.2018	

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar				
Emër	Atësi	Mbiemë r	Leja e legalizimit	
			Numer	Date
1	2	3	4	5
QARKU ELBASAN, ZVRPP GRAMSH, ZONA KADASTRALE 1842				
OSMAN	ZENEL	TAÇE	1020008	9.1.2017
MONDI	OSMAN	TAÇE		
LUAN	OSMAN	TAÇE		
OSMAN	ZENEL	TAÇE	792008	8.2.2017
SAIP	LAVE R	BIBA	528428423	31.1.2018
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526				
NJAZI	MURA	MUSAI	28938	15.3.2013
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8526				
ZAIM	ZALO	NUHU	9997540	12.12.2015
MIDIL	QAZI	BIÇAKU	99632580	21.9.2015
SHPETIM	MIDIL	BIÇAKU	77965322	3.5.2016
ANDRI	MIDIL	BIÇAKU	778526	2.3.2016
SERVET	HYQIME T	DAUTI	990660	6.12.2014
BESIM	OSMA	BALLA	1020680	18.11.2016
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527				
BEHAR	QAMIL	VLLAHI	9925688	15.4.2015
ALBER	QEMAL	VLLAHI	9931251	25.8.2015
SAMI	IBRAHIM	XHAFI	991703	8.1.2015
HAJDA	RUSTEM	BOZHIQI	9928944	24.4.2015
ASTRIT	ASLLAN	SHOTI		2010
SKENDER	SALI	DEDA	992848	20.3.2015
SHEFQET	ISMAIL	RAMA	991755	4.2.2015
AGM	JAHO	ÇEKOJA	2578794	17.4.2018
BASHKIM	YMER	BEQIRI	58987458	20.10.2017
JANI	BAJRA M	GJOCA	79406	11.3.2016
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976, ZVRPP TIRANE				
MERITA	HAMIT	ZEQIRAJ	730890	26.8.2015
FLORINA	HALIT	CAM	1230131	24.7.2018
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170, ZVRPP TIRANE				
NAZMR	RAMAZAN	HIMA	122775	3.11.2017
BLEDAR	NAZMR	HIMA	721449	6.11.2015
MIKEL	NAZMR	HIMA		
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180, ZVRPP TIRANE				
FERIK	XHEVAL	FERRA	19348	4.10.2012
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8210, ZVRPP TIRANE				
ARQILE	KICO	FERI	18354	15.11.2012

ASD organizon mbledhjen e 40-të të siguruesve të Europës, të pranishëm

Gent Sejko: Siguria financiare, element kyç për sistemin bankar

Siguria financiare është element kyç jo vetëm për sistemin financiar, por gjithë ekonominë në tërësi. Agjencia e Sigurimit të Depozitave mbledhi në Tiranë 70 përfaqësues rajonal bankash nga 28 juridiksione të ndryshme. Takimi vjetor u përshëndet njëkohësisht edhe nga kreu i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, i cili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes anëtarëve të rrjetit të sigurisë financiare si një element kyç në administrimin me efikasitet të sistemit financiar. "Marëdhënia ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme dhe përgjatë viteve ka marrë formën e një partneriteti dhe bashkëpunimi të qëndrueshëm, duke i mundësuar institucioneve tona të përbushin misionet e tyre, që, në fakt, plotësojnë njëri-tjetrin", u shpreh Sejko.

TAKIMI

Zhvillimet më të fundit rajonale dhe në juridiksione të veçanta lidhur me sigurimin e depozitave ishin edhe fokusi i mbledhjes së Komitetit Rajonal të Europës, e organizuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave. Kreu i përgjithshëm i ASD-së, Genci Mamani theksoi rëndësinë që kanë këto mbledhje, pasi jo vetëm që ofrojnë mundësi për shkëmbimin e eksperiencave, por njëkohësisht edhe për përfitimimin nga praktikantët më të mirë në fushën e sigurimit të depozitave. Mbledhja e organizuar për herë të parë në një vend jo anëtar të Bashkimit Europian ka merrnin pjesë 70 përfaqësues nga 28 juridiksione të ndryshme, u pasua edhe me një seminar teknik lidhur me "Planet e kontigjencës, menaxhimin e krizave dhe rastet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme". Kështu, gjatë dy ditëve të seminarit teknik pjesëmarrësit patën mundësinë, përmes sesioneve teorike dhe praktike, të njiheshin dhe diskutonin me prezantimet dhe rastet studimore të ekspertëve nga Kanada, Kroacia, Greqia, Italia, Kosova, Holanda, Polonia, Rumania, Rusia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuar si dhe Qendra Këshil-



Kreu i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko

limore e Sektorit Financiar të Bankës Botërore. Në të morën pjesë edhe zyrtarë të

nivelit të lartë të Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë.



Biznesi gjerman i pakënaqur:

Na dëmtojnë taksat, korrupsioni e tensioni politik

Rezultatet e vrotimit të 10 të Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri tregojnë se sipërmarrësit janë të pakënaqur me faktorët ekonomikë. Veç barrës tatimore, disiplinës në pagesa, transparencës së tenderëve publike apo luftës kundër korrupsionit, faktorit që ka sjellë rritje të pakënaqësisë tek bizneset është vetë situata politike. "Bizneset perceptojnë një rënie të madhe në stabilitetin politik dhe social, marrin një notë shumë negative. Pra, ndryshimi këtu është ndryshimi më i madh midis 2018 dhe 2019", tha Bledar Mankollari, drejtor i DIHA-s. Situata është kritike për biznesin dhe për shkak të emigracionit. Largimi i forcës punëtore nga vendi ka ndikuar në kompanitë shqiptare aq sa 13% e tyre vënë në dyshim vazhdimin e ekzistencës së biznesit. "Shumë, 51% e bizneseve shqiptare mendojnë se janë të prekur direkt nga emigracioni i forcës së punës; dhe meatarisht të prekur nga largimi i forcës së punës nga vendi 38%", u shpreh Mankollari. E pranishme gjatë prezantimit të rezultateve të anketimit, ambasadorja gjermane në Shqipëri, Susanne Schutz vuri në pah tendencat kryesore të klimës ekonomike në vendin tonë. "Në tërësi për fat të keq, këtë vit konstatojmë një përkëqim të situatës së përgjithshme ekonomike krahasuar me 2018. Pak më shumë se gjysma e sipërmarrjeve të pyetura e vlerësojnë gjendjen si të keqe. Në këtë mënyrë ky anketim emeton mesazhe të rëndësishme dhe i sinjalizon qeverisë se ku duhet të punojë ende", tha Schutz.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (Consulting Company)

ALBANIA

CITIZEN – CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT
Loan Agreement
Project ID No. 8521

Assignment Title: "The preparation of detailed design for integrated service Delivery centers (ISDC) Lushnje and Ebasan, and supervision for ISDC Lushnje"
Posted: April 08, 2019
Ref. No. Ref. AL-8521-CS/CQ/2.05.09

Under the Innovative Good Governance priority, launched in April 2014, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania" entails a multi-layered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency.

As part of the reform, in October 2014, ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, was established to manage the centralized public service delivery to the citizens.

Project Implementation aims the refurbishment and reconstruction of the selected premise, which is expected to improve the quality of services for citizens by being closer to the public with the offered services.

The scope of this assignments consists in preparation of the design and environmental checklist of the following activities:

Task 1: Preparation of the Designs for ISC Lushnje and Ebasan

Task 2: Cost Estimates, drawings and relevant documents of the envisaged refurbishing works for ISC Lushnje and Ebasan.

Task 3: Supervision of works during reconstruction of ISC Lushnje

COMPANY QUALIFICATIONS

The interested Consultants have to comply with the following minimum qualification requirements:

-The Consultant and its staff must be licensed on the specific categories stated in accordance with Albanian Law. (In design, implementation, supervision of works and environmental studies)

-The tasks shall be performed by Consultant with proven relevant technical experience.

-The consultant must have at least 5 (five) years in design and supervision.

-The consultant must have at least two similar contract including the design and the supervision of works within 5 (five) last years.

The consultant (its staff) should be licensed in design, implementation and supervision works. Licensed in carrying out environmental studies.

Key personnel/Staff

Project Manager

1 (one) Senior Architects / Designers

Licensed architect, with more than 12 years of experience who has a design or technical focus and is responsible for significant parts of the project and worked in at least in 2 similar projects

Very good command of English language

2 (two) Architect / Structural Engineer Licensed architect with 8–10 years of experience who shall be responsible for significant aspects of projects.

- Good command of English language

2 (two) Civil Engineer (s) consultants with at least 10 years of general experience and worked in at least 2 similar projects

The civil engineer(s) shall focus on design work and on the physical aspects of the design.

- Good command of English language

2 (two) Mechanical Engineer graduate degree in field related with mechanical installations

- At least 5 years of general experience at the position of mechanical Engineer of design and/or supervision teams

2 (two) Electrical Engineer

- electrical Engineer with graduate degree in field related with electrical installations

- At least 5 years of general experience at the position of electrical Engineer of design and/or supervision teams

2 (two) Quantity Surveyor

- Quantity Surveyor Engineer, or technician able to check and measure the work quantities

- At least 5 years of general experience at the position of quantity surveyor of design and/or supervision teams

2 (two) Environmental Specialist

- Environmental Specialist with graduate degree in environment

- At least 5 years of experience in environmental issues

The Project Management Unit now invite eligible "Consultants" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualification (CQ) Method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The REOI is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): www.adisa.gov.al.

Expressions of interest (Company Profile, CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by April 23, 2019, at 12.00 local time

ADISA

(Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara)

Bldv: Zhan d'Ark,

Ish shtëpia e oficerave, Kati VI-te

Tirana, Albania

E-mail: roland.larashi@adisa.gov.al;

fiorentina.jorgji@adisa.gov.al

informacion@adisa.gov.al and

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 10 Prill 2019


GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj

"BULEVARDI POLITIK"

- Dy ministrat shqiptarë duke bërë pazar te kalaja e Tiranës
- Çfarë mbeti nga shkatërrimi i 'kërpudhës' së kryeministrit Rama
- Mbrojtja nga mikrobet, arsyeja pse mbretëresha Elizabeth mban dorashka
- Një nënë e përkushtuar si Gjylameti, zbulon pasionin e ri të djalit


Ledri Vula do bëhet baba? Ja si qëndron e vërteta



Ironizon Ronela Hajati: Vidhni pak me stil se përtoni të punoni!



Nga Dafina Zeqiri tek Rita Ora, të famshmit që i kanë mbijetuar periudhës së errët të tyre



Ankthi apo depresioni, Vip-at që kanë luftuar sëmundjet mendore

*Pagjumësia, të qarit,
nervozizmi, problemet që kanë
kaluar personazhet e njohur*

Nga Dafina Zeqiri te Rita Ora, të famshmit që i kanë mbijetuar periudhës së errët të tyre

Ankthi apo depresioni, Vip-at që kanë luftuar sëmundjet mendore

Pagjumësia, të qarit, nervozizmi, problemet që kanë kaluar personazhet e njohur

Pamela Aliaj

Mendoni se për figurat e showbizit çdo gjë shkon vaj? Gaboheni! Ankthi dhe depresioni janë dy probleme të shëndetit mendor që sa vjen dhe po shënojnë një rritje edhe në vendin tonë. Çrregullimet e ankthit zënë vendin e parë të shqetësimeve sipas mjekëve dhe shkaktarët janë të shumtë. Në botën e figurave të njohura televizive ka shumë raste kur të famshmit kanë treguar se kanë vuajtur nga ankthi dhe depresioni ose vuajnë. Shumë prej tyre u është dashur të përballen me sëmundje mendore dhe kanë gjetur guximin t'i luftojnë duke folur për to. Në shumicën e rasteve kjo është një çështje mjaft delikate që kërkon një trajtim të menjëhershëm. Megjithatë është e vështirë, sepse një pjesë e madhe që vuajnë nga kjo gjë nuk arrijnë ta pranojnë, madje e mbajnë të fshehtë. Por siç e thotë dhe shkenca dhe si të gjithë e dimë depresioni, ankthi apo çdo problem tjetër mendor nuk mund të trajtohet nëse nuk flasim hapur për këtë gjë. Pas disa vetëvrasjeve të njëpasnjëshme në botën e 'Hollywood-it' dhe kryesisht showbiz-it të huaj, duket se një pjesë e madhe e artistëve janë ndërgjegjësuar dhe kanë folur për problemet e tyre mendore dhe si ia kanë dalë mbanë. Një ndër personazhet që ka folur hapur rreth këtij problemi ishte këngëtarja shqiptare me famë botërore Bebe Rexha. Në një intervistë për "Teen Vogue" përveç të tjerash ajo u shpreh dhe rreth sëmundjes së saj: "Unë qaj shumë. E kam të vështirë. Kam terapistin tim dhe kam njerëz me të cilët flas. Është një betejë e përditshme, mendoj", u shpreh ajo. Në Shqipëri janë të pakta të tilla raste, por më poshtë do t'ju listojmë disa prej tyre që pranuan që kanë kaluar një situatë të tillë për t'u dhënë zemër të tjerëve për të kaluar një situatë të tillë delikate për shëndetin mendor.

FLAKA KRELANI
Këngëtarja e njohur ka bërë një rrëfim të sinqertë në rrjetet sociale, në lidhje me periudhën e errët të jetës së saj. "Fundi i vitit 2018 dhe fillimi i vitit 2019 ka qenë i vështirë për mua fizikisht dhe mendërisht. Arsyja që po shprehem kaq shumë, është, sepse secili prej nesh ka vështirësi të cilat janë normale, zhgënjimet gjithashtu janë normale, si mungesa e motivimit, nuk është fundi i botës apo gjëra



Dafina Zeqiri



Bebe Rexha



Flaka Krelani



Albano Bogdo

të tjera që na bëjnë të ndihemi keq. Do të doja të gjitha të ishin si ilaçe që të mund t'i konsumoja çdo ditë, sepse më ndihmojnë të arrijë gjithçka që dua në jetë. Ajo që jemi, është ajo për të cilën jemi të gatshëm të luftojmë. Kthejeni veten në prioritet dhe mos e ktheni "problemin" në problem, sepse ai nuk ekziston.

Shëndeti është e vetmja gjë e rëndësishme në jetë", ka shkruar këngëtarja. Ajo ka marrë menjëherë një mbështetje shumë të madhe nga fansat dhe guximi i saj është përgëzuar nga të gjithë. **DAFINA ZEQRIRI**

Dafina ka publikuar në Instagram një shkrim të një artisteje amerikane, e cila ka rrëfyer se

ajo çdo ditë praktikohet dhe kujdeset për shëndetin e saj mendor, duke qenë se vite më parë ka vuajtur nga dëshpërimi dhe në disa raste ka tentuar dhe vetëvrasjen. Pas kësaj këngëtarja shqiptare ka thënë se familja dhe fansat e saj nuk e kanë menduar asnjëherë se e ka kaluar dhe ajo këtë gjendje. Më pas Dafina ka dhënë dhe një mesazh shumë të rëndësishëm për të mbrojtur veten nga depresioni dhe për të shpërndarë më shumë dashuri me njëri-tjetrin. "Depresioni është real dhe mund të jetë i dukshëm. Flisni! Kujdesuni për njëri-tjetrin! Mos e merrni mirësinë për dobësi! Mos e merrni dashurinë, besnikërinë dhe suportin të garantuar! Ju dua me gjithë zemër!", - ka shkruar këngëtarja shqiptare. Mesa duket dhe këngëtarja ka kaluar një problem të tillë më parë.

LORI HOXHA

Fotot e bukura veshjet e shtrënjta janë vetëm fasada. Megjithatë, përtej Instagramit, askush nuk është në dijeni të vështirësive që kanë personazhet e njohur. Lori Hoxha, ka vendosur të ndajë para disa kohësh një fakt jo pak të rëndësishëm me ndjekësit në Snapchat. "Një fakt i vogël: ankthi nuk më lë të fle", ka shkruar ajo teksa pati postuar një foto. **BEBE REXHA**

Ajo kohët e fundit ka dhënë një intervistë për "Teen Vogue" ku ka rrëfyer eksperiencat e saj muzikore dhe ka folur për herë të parë për shëndetin e saj mendor. "Unë qaj shumë. E kam të vështirë. Kam terapistin tim dhe kam njerëz me të cilët flas. Është një betejë e përditshme, mendoj. Unë nuk dua ta ushqej, por jeta ime është kaq e çmendur. Kur shkova fillimisht në vitin e

parë të kolegjit, isha kaq intensive. Unë nuk dija se si të reagoja dhe të përfshihesha mes njerëzve. Unë kam qenë shumë e shqetësuar gjatë gjithë kohës. Isha e shqetësuar kur isha një vajzë e vogël, thjesht nuk e dija se çfarë ishte. Së fundi, kur e kuptova, isha si 'Oh... Më në fund, e kuptoj. Kam ankth' - është shprehur këngëtarja shqiptare. **ALBANO BOGDO**

Në një rrëfim të sinqertë për emisionin "Rreze Dielli", aktori i humorit Albano Bogdo ka rrëfyer luftën e tij me ankthin dhe depresionin, që e çuan te pija. Ai ka luftuar shumë për të qenë ky që është sot, pasi ka pasur probleme, shkak për të cilat është bërë ankthi. Ai madje rrëfeu se si pasojë e kësaj jete që bënte, u nda dhe nga e fejuara. "Për rreth tre vjet e gjysmë jam kuruar dhe vazhdoj të kurohem, sepse më zë paniku dhe ankthi. Unë, që t'i bija shkurt, zgjodha pijen dhe jetën e shfrenuar. Pija 2 shishe alkooh në ditë dhe kjo zgjati për afro një vit e gjysmë-dy vjet. Tani më duket sikur më zënë mallkimet e 300-400 njerëzve që kam lënduar", është shprehur aktori i humorit, i cili deklaroi më tej se prej këtij problemi ai ishte ndarë dhe nga e fejuara. **RITA ORA**

Ishte viti 2016, kur Rita Ora, në një intervistë pranoi se vuante nga ankthi dhe se i gjithë shqetësimi i ishte përforcuar gjatë viteve. "Vuaj nga ankthi dhe kam frikë të pranoj që kam qenë në terapi. Edhe kohët e fundit flas me një specialist një herë në javë", ka deklaruar këngëtarja. Siç shkruan "Mirror", ktrizat e ankthit i kanë lindur këngëtares që në fëmijëri, nga frika që kishte prej vdekjes.



Lori Hoxha

Këngëtarja e njohur shqiptare, Rita Ora po shoqërohet nga nëna e saj, Vera Ora kudo që ndodhet. Kësaj radhe mamaja e këngëtares, Vera ka postuar një fotografi me Ritën, ku shihen në një vend të Kosovës që ato kanë për të vizituar gjatë misionit tre-ditësh në vendlindje. Rita shihet në veshje e dukje shumë të thjeshtë, ndërsa nuk e ka ndaluar as dita me shi për të bërë atë për të cilën ka ardhur, si ambasadore e UNICEF për t'i dalë në ndihmë fëmijëve në nevojë. Një gjest vërtet për t'u vlerësuar!



Rikthehet Rita Ora në Kosovë, nis me nënën misionin e saj të bamirësisë

Vetëm pak kohë ka mbetur nga ardhja në jetë e fëmijës së tyre të parë. Ish-misi shqiptar, Almeda Abazi dhe bashkëshorti i saj, aktori i njohur turk, Tolgahan Sayisman kanë publikuar një imazh të këndshëm si çift. Almeda Abazi po shijon ditët e fundit të shtatzënisë, ndërsa nuk i kursen fotot me barkun e rrumbullakosur. Çifti ka postuar një fotografi në Instagram, në të cilën shfaqen të përqafuar ndërsa Almeda shihet me barkun e rrumbullakosur. Ata janë veshur me ngjyra të kombinuara kuq e zi, ndërsa duken shumë të lumtur pranë njëri-tjetrit.



Veshur kuq e zi, Almeda dhe bashkëshorti bëjnë fotosesionin e shtatzënisë

Mesa duket pa qenë konsoliduar në një lidhje, reperi i njohur kërkon të bëhet prind. Po flasim pikërisht për Ledri Vulën, i cili ka shprehur dëshirën për t'u bërë me fëmijë vetëm për të parë sesi është ndjenja e të qenit prind. I ftuar në emisionin "N'drrimi i natës", Ledri Vula tha se është i gatshëm të krijojë familje. Ai shtoi se ka shokë që janë bërë me fëmijë dhe janë pikërisht ata që ia shtojnë dëshirën. "Jam shumë i gatshëm të krijoj familje. Si mund mos të jem i gatshëm kur shoh shokët e mi me fëmijë, si pëllumba. Unë luaj me fëmijët e tyre si t'i kem të mitë. Kur i shoh rrethin shoqëror që janë bërë prindër, them edhe unë dua. Ata dalin me fëmijë kurse unë nuk mundem. Kush është bërë prind thotë që ajo ndjenjë ta ndryshon jetën. Dua ta di si është kjo ndjenjë që e keni përjetuar ju", u shpreh Ledri.



Ledri Vula do bëhet baba? Ja si qëndron e vërteta

Nuk mungojnë rastet kur artistët shqiptarë kanë 'huazuar' diçka nga këngëtarët e huaj. Nuk dihet nëse mund ta quajmë plagjiaturë të pastër por rastet nuk kanë munguar. Së fundmi këngëtarja e njohur, Ronela Hajati, ka reaguar lidhur me këtë temë duke kritikuar publikisht kolegët që kopjojnë. Me doza ironie ajo u ka dhënë dhe një këshillë se si ta bëjnë më pak të dukshme "vjedhjen". "Ore vidhni o shpirta, po vidhni pak me stil se kuptohet që përtoni shumë të punoni", - ka shkruar Ronela në 'Instastory'. Ajo nuk ja ka adresuar dikujt në veçanti mesazhin, por me siguri të gjithë ata që ajo ka pasur si qëllim do e kenë kuptuar shumë mirë. Ronela ka guxuar gjithmonë t'i shprehë mendimet hapur dhe të kritikojë kur shikon se diçka nuk po ecën mirë në fushën ku lëvtron. Së fundmi, këngëtarja ka udhëtuar drejt Portugalisë, sepse është e ftuar speciale në një nga emisionet më të njohura atje.



Ironizon Ronela Hajati: Vidhni pak me stil se përtoni të punoni!

BULEVARDI

POLITIK

Na merrni seriozisht!

Dy ministrat shqiptarë duke bërë pazar te kalaja e Tiranës

Në një tjetër dyqan me produkte organike te Kalaja e Tiranës u panë duke bërë pazar ministrja e Kulturës Elva Margariti dhe homologu kosovar Kujtim Gashi. Margariti dhe Gashi shihen duke bërë pazar në një dyqan brenda Kalasë së Tiranës, i cili tregon produkte nga më të ndryshmet të prodhuara në vendin tonë. Mesa duket ashtu si presidenti dhe ministrat duan të promovojnë produktet bio vendase. Pak ditë më parë edhe Presidenti Ilir Meta, i veshur me xhins, publikoi disa foto duke bërë pazar në një dyqan të ri të hapur te Kodra e Diellit.



Çfarë mbeti nga shkatërimi i 'kërpudhës' së kryeministrit Rama

Kërpudha e vendosur te Kryeministria ishte një nga veprat e artit e cila nuk i mbijetoi zemërimit të protestuesve në tubimin e thirrur nga PD në fillim të shkurtit 2019. Ndonëse ajo ishte mbuluar me një skelë hekuri dhe rrjetë, ashtu si hyrja ballore, protestuesit nuk e kursyen. Tashmë vepra e Carsten Holler, pjesë e një cikli të ekspozuar në disa muze dhe dhuruar Kryeministritë pas një vizite të artistit të njohur në vendin tonë, ekziston vetëm në foto të shkrepara herët.



Një nënë e përkushtuar si Gjylameti, zbulon pasionin e ri të djalit

Kohët e fundit kemi vënë re një krisje të marrëdhënies së kryetares së PS në Tiranë, Blerina Gjylameti me kryeministrit Edi Rama, i cili pas një përplasjes në Kongresin e PS e shkarkoi nga posti i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Sherri për listën e kandidatëve për këshillin bashkiak të Tiranës duket se e penalizoi Gjylametin edhe kjo e fundit nuk e pranoi një gjë të tillë. Këtë fundjavë kryetarja e PS në Tiranë duket se ka vendosur të relaksohet dhe të kalojë pak më shumë kohë me familjen. Gjylameti ka publikuar në Instagram një foto të djalit Joelit, i cili shfaqet duke gatuar një omlëtë. 'Pasion i ri', shkruan deputetja e PS, e cila përveçse na zbulon pasionin e djalit, na tregon që është një nënë e përkushtuar.



Mbrojtja nga mikrobet, arsyeja pse mbretëresha Elizabeth mban dorashka

Mbretëresha Elizabeth e Anglisë dhe pasioni i saj për dorashkat! Prej 67 vitesh sovranja e Anglisë, nuk heq dorë nga ky detaj. Të verdha, limoni, të bardha, të kaltra, mbretëresha përsëhendet gjithnjë me dorashka në duar, në evente publike. Nuk bëhet fjalë për një ves estetik, por për një motiv konkret! Mediat angleze shkruajnë se sovranja nuk rri asnjëherë pa dorashka, për t'u mbrojtur nga mikrobet. Në rastin e eventeve publike, madhëria e saj duhet të shtrëngojë duart me shumë njerëz dhe kjo gjë rrezikon që ta vendosë në kontakt me shumë baktere. Dorashkat që mban mbretëresha janë të markës 'Cornelia James' dhe kushtojnë mesatarisht 150 dollarë. Mbretëresha mban gjithmonë me vete dy-tre palë, dhe prej tyre ka modele që i përdor prej 40 vitesh.

SHKURT
Furnizues i klasit të I,
kapet shqiptari me 600
mijë euro kokainë

ITALI - Policia italiane ka arrestuar një shqiptar, të cilit iu gjetën 3 kg kokainë. Valentin Tuku, 37 vjeç jetonte me dokumente të rregullta e punonte në zonën e Maranelos, duke mos lënë dyshime se merrej me trafikimin e lëndëve narkotike. Operacioni policor nisi ditën e shtunë, kur policia shkoi në shtëpinë e Tuku dhe nisi kontrollin. Ai ishte duke dalë nga banesa, kur u përball me agentët e policisë. Në çantën e shpinës policia i gjeti një pako kokainë, 1 kg. Kërkimi vazhdoi në garazhin e shqiptarit, ku u gjetën dy pako të tjera të fshehura në shalën e motorit. Nëse do të shitej kokaina, shqiptari do fitonte plot 600 mijë euro. Sipas hetuesve, shqiptari ishte një emër i njohur në tregtinë e drogës dhe një furnizues i klasit të parë për shitësit e drogës në burg, deri në pritje të gjyqimit nga ana e autoriteteve italiane.

Sekuestrohen edhe municione,sherr në

Korçë, pranga agresorit KORÇË - Ndërhyrja në kohë e policisë së Korçës ka parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti mes dy personash. Në pranga përfundoi një 19-vjeçar, të cilit pas kontroleve në banesë iu gjet një armë dhe disa municione luftarake. "Ndërhyrja në kohë e policisë, parandalon përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti. Arrestohet në flagrancë një shtetas për veprat penale "Kanosja" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve e municionit".

Sekuestrohet një armë zjarri e municione luftarake, të cilat i posedonte pa leje në banesë. Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Korçë, pas marrjes së njoftimit se në dalje të qytetit, dy shtetas po konfliktoheshin për motive të dobëta, kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të konfliktit midis shtetasit M.I, 19 vjeç dhe një 38 vjeçari, banues në Korçë. Në vijim të veprimeve të tjera procedurale, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit M.I, iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë automatike (së cilës i mungonin disa pjesë të saj) me 3 kërra fishkësh, si edhe 817 copë fishkësh luftarakë. Shtetasi M.I, u arrestua në flagrancë për veprat penale të lartpërmendura dhe materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për veprime të mëtejshme"-njoftoi policia.

Droga e kapur në Maminas, në pranga vetëm shoferi

613 kg kokainë fshehur në banane, Arbër Çekaj kërkon azil në Gjermani



PRONARI I BANANEVE

Shtetasi Arbër Çekaj rezultonte të ishte larguar nga Shqipëria 3 javë para se të sekues-

trohej sasia rekord e kokainës dhe që në atë moment policia bëri shpalljen në kërkim ndërkombëtar, pasi kishte dyshime se ai ndodhej në Gjermani. Sipas policisë, Çekaj, i cili kishte porositur kontenerin me 20 tonë banane nga Kolumbia, duket se kishte porositur

edhe 613 kg kokainë. Ai është aksioneri i vetëm i kompanisë "Arbri Garden", siç del nga kërkimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Nga një kërkim në internet, rezultoi se firma "Arbri Garden" ka marrë 97 ngarkesa nga Amerika e Jugut që prej vitit 2012. Për sas-

inë rekord të kokainës, më 28 shkurt u arrestua Armando Pezaku, që drejtonte kamionin me targë DR 3819 dhe Donald Lushaj, që ndodhej si pasagjer, i cili kishte detyrën e menaxherit dhe do merrte në dorëzimin mallin e mbërritur nga Kolumbia.

Operacioni ndaj mafies shqiptare nga Europoli, vetëm 15 mbeten në qeli

Goditja anti-mafia, lirohen 40 shqiptarët e arrestuar

Policia europiane zbuloi 17 plantacione kanabisi

BELGJIKË

Prokuroria belge ka mbajtur në arrest 15 nga 55 personat e ndaluar të premtën. Aksioni anti-drogë është përkrahuar si goditje "kundër mafies shqiptare në Evropë". Europoli njofton për arrestimin e 60 personave. Në kumtesën e Europolit thuhet se në "aksion kanë marrë pjesë 650 policë në Belgjikë, Holandë, Francë, Itali dhe Mbretëri të Bashkuar, të cilët kanë bastisur disa adresa në koordinim me autoritetet në Serbi". Në pyetjen, nëse aksioni është bërë në koordinim edhe me autoritetet në vendet tjera të Ballkanit, zëdhënësi i Europolit Jan Op Gen Oorth ka thënë se organizata "ka përkrahur qarkullimin e informacionit në mes të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera me të cilat rrjeti ka pasur kontakte duke përfshirë edhe ato në Ballkanin Perëndimor".

TREGU I KANABISIT

Zëdhënësi ka refuzuar që të zbulojë nacionalitetin e të arrestuarve duke i përmbledhur të gjithë në "mafia shqipfolëse". Gjithsej janë zbuluar 17 plantacione të kanabisit dhe policia ka konfiskuar 8.000 rrënjë të bimës, 200 gr kokainë, kompjuterë, telefon, dokumente, kesh dhe gjashtë vetura luksi. Sipas Qendrës evropiane për monitorim të drogave dhe varësisë nga drogat, në vit bëhen rreth 22 mijë aksione të konfiskimit të rrënjëve të kanabisit me mbi 10 milionë bimë të konfiskuara. Këto rezultate kanë kulmuar në vitin 2015 kur janë konfiskuar 11,5 milionë bimë. Tregu i kanabisit përbënë 38 për qind të tregut të përgjithshëm të drogave të jashtë ligjshme, me vlerë prej rreth 9.3 miliardë euro. Një pjesë e madhe e këtij kanabisit prodhohet në ambiente të mbyllura brenda BE-së përdërisa importet me të mëdha vinë nga Maroku dhe Libia. Një pjesë të kanabisit vjen nga Ballkani Perëndimorë prej vendeve si Serbia, Kosova, dhe Shqipëria. Sa i përket prodhim-



KANABISI

Zëdhënësi ka refuzuar që të zbulojë nacionalitetin e të arrestuarve duke i përmbledhur të gjithë në "mafia shqipfolëse". Gjithsej janë zbuluar 17 plantacione të kanabisit dhe policia ka konfiskuar 8.000 rrënjë të bimës, 200 gr kokainë, kompjuterë, telefon, dokumente, kesh dhe gjashtë vetura luksi.

it brenda BE-së grupet e organizuara kriminale holandeze përbëjnë pjesën më të madhe të prodhimit, thuhet në raport. Krahasuar me të dhënat e përgjithshme sasia e konfiskuar e kanabisit në këtë aksion nga "mafia shqiptare" përbënë më pak se 0.1 për qind të sasisë së përgjithshme të konfiskuar në BE gjatë një viti.

PSE U LIROJAN SHUMË TË ARRESTUAR?

Sa i përket këtij rasti nga 55 arrestimet 15 janë ndaluar në polici për t'u hetuar për qëndrim ilegal në vend, transmetojnë mediat lokale pohimet e prokurorisë belge. Mbetet e paqartë pse shumica e të arrestuarve janë liruar dhe, nëse kundër tyre janë ngritur akuzat për t'u lënë të mbrohen në liri. Europoli ka kumtuar se "hetimi ka pasur për cak organizatat kriminale të përfshira në shumë aktivitete, duke përfshirë trafikimin e kanabisit në sasi të mëdha, trafikimin e kokainës, prostitucionin, trafikimin e qenive njerëzore dhe

pastrimin e parave" ka thënë një zëdhënësi i prokurorisë për mediat lokale belge.

Prokurori belg Christian Henry nga Tournai-Mons, i ka thënë gazetës lokale De Standaard se grupi ka pasur lidhje me gra bullgare të vendosura në qytetin Einthoven të cilat janë transferuar në plantazhe që të vjelin kanabisin sipas nevojës. I tërë aksioni është pjesë i një projekti të financuar nga Komisioni Evropian të quajtur: Direzione Investigativa Antimafia Project ONNET, që ka për qëllim ndjekjen e grupeve mafioze në Evropë. Projekti ka filluar në nëntor 2018 dhe përbëhet nga 6 vende anëtare të BE-së, Italisë, Belgjikës, Francës, Gjermanisë, Holandës, Spanjës dhe Europolit. Projekti ONNET i ka cak grupet mafioze si tërësi e jo ndjekjen e tyre për aktivitetet të caktuara. Grupet kryesore cak i projektit janë grupet mafioze italiane, rrjetet euro aziatike dhe shqiptare të mafias si dhe bandat jashtëligjore të motoristëve.

Vjedhje dhe mashtrim, arrestohet dibrani i kërkuar në Gjermani

DIBËR - Një 34-vjeçar nga Dibra i akuzuar për vjedhje dhe mashtrim kompjuterik është arrestuar dje nga policia. Mësohet se B.C. jetonte në Maqedoninë e Veriut, ndërsa pas arrestimit pritet të ekstradohet në Gjermani.

"Specialistët për Hetimin e Krimin të Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër në bashkëpunim me Komisarariatin e Policisë Kufitare dhe Interpol Tirana bënë arrestimin e përkohshëm të shtetasit B.C., banues në Maqedoninë e Veriut. Ky shtetas ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Wiesbaden/Gjermani pasi Gjykata e Aachen Gjermani, me datë 22.03.2013, ka lëshuar urdhrin e arrestit për shtetasin B.C., për veprat penale "Vjedhje" dhe "Mashtrim kompjuterik". Materialet hetimore do të kalojnë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër për veprime të mëtejshme"-thuhet në njoftimin e policisë.



BOTIMI

"E përdhunuar", të fitosh luftën e kthimit në normalitet

Një libër me një titull të rëndë..., por kush tha se jeta është e lehtë? Ajo që i ndodh Frankës në këtë roman, mund t'i ndodhë kujtdo në këto kohë kaq pak të sigurta. Franka mund të ishte vajza ime, mund të jetë motra apo shoqja jote e klasës. Franka është secila prej 17 vjeçareve të ditëve të sotme.

E, Franka në roman, përjeton tmerrin e përdhunimit... Ç'mund t'i shkojë më keq në jetë një vajze 17 vjeçare, të dashuruar me jetën, e lirshme, e sigurtë dhe që gëzon e jeton çdo ditë?

Miq, shkollë, festa, herë pas here edhe ndonjë punë, për t'i treguar prindërve që është e zonja. Pra, jeta normale e një vajze të moshës së saj..., deri në çastin kur, një mbrëmje, teksa kthehej nga puna, një i panjohur e sulmon dhe e përdhunon.

Deri në këtë pjesë të librit shkrihtarja Jutta Treiber përdor të gjithë energjinë që mund të përcjellin fjalët për të treguar natyrën e shpenguar e të gjallë të Frankës. Por, pas përdhunimit, Franka nuk ka lidhje me vajzën e dikurshme.

Në këtë pjesë të librit janë prindërit e saj ata që marrin të gjithë situatën në dorë. Një nënë sa e ndjeshme, aq edhe e fortë. Një baba i tronditur nga dhimbja, por i kthjellët për të kuptuar se çfarë është më e rëndësishme në një situatë të tillë. Natyrisht, përballimi i asaj që ndodhi dhe kthimi i të bijës në normalitet mbetet gjëja më e rëndësishme.

Në këtë roman me një histori tronditëse, autorja nuk fokusohet

tek gjetja e fajtorit, madje, për të, ai është periferik. Dhimbja e ndjenja e fajtit nuk i verbojnë prindërit e saj, për të harruar vajzën dhe të rendin në kërkim të fajtorit.


Është e vështirë të lësh pas kraheve një ndodhi të tillë, por Franka ia doli falë prindërve të saj.

Tërheqëse dhe jashtëzakonisht e ndjeshme në rrëfim, Jutta Treiber përshkruan efektet e përdhunimit të një vajze. Shkrimtarja nuk e shmang kërkimin e fajtorit dhe të shkaqeve të përdhunimit, por ajo përqendrohet tërësisht te Franka dhe prindërit e saj, si dhe te fazat e ndryshme shpirtërore që ajo kalon pas përdhunimit, si dhe vështirësitë e kthimit në "normalitet".

Ky libër është i përshtatshëm për adoleshentët dhe të rriturit.

Franka është vajzë e guximshme, plot energji dhe vetëbesim. Franka ecën përpara me këmbëngulje. Hedh hapa të pjekur dhe energjikë. Nuk i intereson shumë se çfarë ndodh përreth. Franka jeton vetëm jetën e saj, takimet me miqtë, shkolla, vallëzimi dhe një punë si dado-kujdestare fëmijësh. Gjithçka duket normale deri kur një natë, Franka 17 vjeçare, sulmohet dhe përdhunohet nga një i panjohur në rrugën e shtëpisë së saj. Prej asaj dite asgjë nuk do të jetë si më parë...

Me një stil energjik dhe mjaft bindës, shkrihtarja e njohur austriake Jutta Treiber i jep rëndësi në mënyrë të veçantë jetës dhe gjendjes shpirtërore të viktimës, duke treguar qartë se sa e vështirë është ta fitosh luftën e kthimit në "normalitet". Shkrimtarja e



SKEDA E BOTIMIT

Jutta Treiber
E përdhunuar - roman
Përktheu nga originali: Admira Poçi
Redaktoi dhe përgatiti botimin: Silvana Leka
Faqe 200
Çmimi 1000 lekë
Botimet POETIKA,
Tiranë, prill 2019
ISBN 978-9928-230-28-7
Titulli i origjinalit: "Vergeäaltigt"
Letërsi austriake

njohur austriake Jutta Treiber ka shkruar romane për të rinj e të rritur, libra për fëmijë, poezi, drama dhe tregime. Krijimtaria e saj është nderuar nga Bashkia e Vjenës me Çmimin Libri më i mirë për Fëmijë si dhe Çmimin Libri më i mirë për të Rinj. Ajo është nderuar edhe Çmimin mbarëaustriak për Librin më të mirë për të Rinj. "Krijimtaria e shkrihtarës Jutta Treiber e ka pasuruar ndjeshëm letërsinë në gjuhën gjermane dhe ka kontribuar shumë në vendin kulturor që zë Austria në botë", është shprehur Presidenti Federal Dr. Heinz Fischer. Deri më sot librat e Jutta Treiber janë përkthyer në 25 gjuhë të botës. Libri u botua në bashkëpunim me rrjetin TRADUKI.

KALENDARI KULTUROR SHQIPËRI-KOSOVË

Për të gjashtin vit, Shqipëria dhe Kosova kanë një kalendar të përbashkët kulturor. Në ambientet e Ministrisë së Kulturës, Ministria i Kulturës së Shqipërisë, Elva Margariti dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Kujtim Gashi nënkruan kalendarin që përfaqëson ngjarjet e artit në dy shtetet. Të detajuara janë Aktivitetet në të gjitha institucionet e kulturës si Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, Teatrin Kombëtar, Teatrin Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Galerinë Kombëtare të Arteve në Shqipëri dhe atë në Kosovë, Ansambli Popullor "Shota", Qendra Kombëtare Kinematografike të Kosovës, Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit Shqiptar, Qendrën Kombëtare të Fëmijëve në Tiranë, Qendrën Kombëtare të Fëmijëve në Prishtinë, etj. Nuk mungojnë as aktivitetet kushtuar librit apo ato për trashëgiminë kulturore.

Për Ministrën Margariti ky

kalendar është vetëm shenja zyrtare e një bashkëpunimi mes dy vendeve, që tashmë ndihen si një familje e madhe. "Prej vitit 2014 kultura e ka kthyer Shqipërinë e Kosovën në një familje të madhe. Kultura i ka kaluar kufijtë shumë më shpejtë se të tjera dimensionet që lidhin dy vendet tona dhe aktivitetet janë vetëm disa pika të formalizuara brenda një kalendari, në një kohë që kemi dakordësinë që do të kenë edhe shumë të tjera më pas. Kjo traditë po bën pjesë të sajën gjithnjë e më shumë njerëz, duke u kthyer në një urë lidhëse dhe jam kërenare që bashkë me homologun tim kemi ndarë ide për aktivitete të tjera në vazhdim", u shpreh Margariti.

Ndërsa ministri i Kosovës, Gashi, përtej kënaqësisë së finalizimit të një kalendari të pasur kulturor, u shpreh se ky nënshkrim përbën një moment të rëndësishëm edhe për komunitetet artistike që

MINISTRAT E KULTURËS, PROJEKT PËR NGRITJEN E NJË FONDI TË PËRBASHKËT NË NDIHMË TË SKENËS ARTISTIKE TË PAVARUR



gjejnë më shumë hapësira shprehëse në të dy anët e kufirit.

Ai e shtyu bashkëpunimin edhe më tej, duke e nxjerrë atë nga suaza institucionale, për t'u shtrirë edhe në skenën e pavarur. "Me ministrin Margariti diskutuam sot krijimin në një të ardhme të afërt, të një fondi të përbashkët kulturor.

Me këtë kuptojmë që nga mbështetja e aktivitetëve në institucionet kulturore, të shkojmë tek pjesa e aktivitetëve në skenën e pavarur kulturore që edhe në Kosovë e në Shqipëri kanë marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm. Pra, të mund të mbështesim financiarisht edhe skenën e pavarur. Dhe

besoj se në muajt e ardhshëm të dy institucionet do të gjejnë gjuhën e përbashkët dhe mundësinë administrative, që në fund të vitit të krijohet që fondi i përbashkët, që të mund të implementohet në vitin 2020"

Më tej, axhenda e përbashkët vijoi me një vizitë në ekspozitën e artistit kosovar Sokol Beqiri, "As mik, as armik", hapur në Galerinë Kombëtare të Arteve, me rastin e 20-vjetorit të ndërhyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, por njëkohësisht edhe aktiviteti i parë që ngrii siparin e kalendarit kulturor. Ministria Margariti e quajti një moment ku bëhet bashkë gëzimi dhe dhimbja, të cilën artistët dinë ta shprehin më mirë me artin e tyre. Një tjetër vizitë u zhvillua në Kalanë e Tiranës, ku investimet e fundit e kanë kthyer atë në një nga qendrat më atraktive turistike të qytetit.

RAPORTI VJETOR

Janë paraqitur 57 kërkesa me objekt rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të vdekurve apo të të zhdukurve. Janë kërkesa me objekt qartësimin e rrethanave të vrasjes a vdekjes...

AUTORITETI I DOSJEVE

Në kërkim të të zhdukurve me forcë në komunizëm

Fatmira Nikolli

Aktivite për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtën e viktimës për të njohur të vërtetën, njohjen mbi pasojat e zhdukjes me forcë, që do t'i hapë rrugë sigurimit të drejtësisë, hetimin e rasteve dhe sjelljen e shkelësve para drejtësisë, mjetet efektive dhe kompensimin si dhe ruajtjen e memorie historike për ato raste që kanë ndodhur gjatë periudhës së komunizmit".

Është kjo një ndër pikat më kryesore të punës së Autoritetit të Dosjeve, siç del nga një material që ka të bëjë me raportin e tyre vjetor. Më në fund duket se një institucion merr përsipër të hedhë dritë mbi fatin e të zhdukurve e njëherësh iu hap rrugë hetimeve për personat përgjegjës.

Përmes një materiali dërguar mediave, Autoriteti ndalet gjatë të Konventa Ndërkombëtare e OKB "Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë" dhe të raportimi mbi kërkesat drejtuar Autoritetit nga individët për rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të të vdekurit apo të zhdukurit.

Duke vënë në dukje detyrimet që rrjedhin nga Konventa e OKB-së, AIDSSH thotë se është angazhuar aktivisht dhe ka bashkëpunuar me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), Institutin i Integritetit të të Përndjekurve Politikë, institucionet e tjera publike në vend dhe vijon të japë kontributin e vet konkret në sigurimin e informacionit dokumentar të lidhur me ta, po ashtu, në ngritjen e çështjes me institucione publike e ndërkombëtare për avancim të kërkeve.

Vlen të theksohet fakti se "Zhdukjet me forcë" janë parashikuar si vepër penale referuar ndryshimeve të Kodit Penal të miratuara në vitin 2013. Gjatë raportimit në Gjenevë, Autoriteti ka dhënë llogari për nisimat dhe punën e bërë.

KËRKESAT

Ndërkohë, gjatë vitit 2018 në adresë të Autoritetit janë paraqitur 57 kërkesa me objekt rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të vdekurve apo të të zhdukurve. Rezultoni se 35 kërkesa janë përfunduar (evidentuar) me vendimmarrje të Autoritetit dhe në proces verifikimi janë 22 kërkesa. Për kërkesat e përfunduara për të cilat Autoriteti, aplikuesve u ka vënë në dispozicion dublikata të dokumentacion-



it arkivor, janë kërkesa me objekt qartësimin e rrethanave të vrasjes/ vdekjes, pasi viktimës në herët nga ana e familjarëve i janë gjetur eshtrat dhe identifikuar vendvarrimi.

Kurse për kërkesat e përfunduara, për të cilat Autoriteti është shprehur me vendim se nuk disponohet dokumentacion arkivor, rezultojnë kërkesa të paraqitura nga familjarët e personave të zhdukur apo të vrasës pa gjyq, nga forcat e regjimit komunist për të cilët nuk janë gjetur eshtra apo vendvarrimi i tyre.

Vitin e shkruar është bërë prezantimi bashkë me ICMP-në i dy aplikacioneve online që do të ndihmojnë procesin e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri. Këto aplikacione ndihmojnë familjarët e personave të zhdukur të raportojnë rastet si dhe të marrin informacion në lidhje me statusin e rasteve individuale të personave të zhdukur. Treguesi i vendvarrezeve i mundëson përdoruesve që në mënyrë anonime të japin informacion mbi vendndodhjen e varrezeve ku mund të gjenden mbetjet njerëzore të personave të zhdukur. Aplikacionet janë publikuar dhe vendosur në faqen zyrtare në AIDSSH-së, për të gjithë të interesuarit.

AIDSSH ka bashkëpunuar me prokurorinë për fillimin e procedurës së gjetjes dhe identifikimit të vendvarrimeve të personave të zhdukur në diktaturë, si dhe me



"Do t'i hapë rrugë sigurimit të drejtësisë, hetimin e rasteve dhe sjelljen e shkelësve para drejtësisë"

qeverisjen lokale, duke paraqitur propozime konkrete për vendet e kujtesës.

Me 21 mars 2019, AIDSSH në bashkëpunim me IIPP dhe ICMP vizituan ish-kampin e punës së detyruar në Ballsh. Gjithashtu, u takua me Drejtuesin e Prokurorisë së Qarkut të Fierit dhe Kryetarin e Bashkisë Mallakastër ku u diskutua për bashkëpunimin ndër-institucional për kërkimin e personave të zhdukur gjatë periudhës së regjimit komunist. Pritet që së shpejti, pas lëshimit të urdhërës nga ana e Prokurorisë, të fillojë zhvarrimet në varrezat e ish burgut - Reparti 309 në "Panahor".

VENDET E NDRËGJEGJES

Me ligjin e ri të trashëgimisë, AIDSSH ka propozuar që vendvarrimet e fshehta dhe vend ekzeku-

timet të jenë vende të ndërgjegjes.

Si vende kujtese dhe vetëdijësimi, vendet e pushkatimit dhe vendvarrimet e fshehta të periudhës së diktaturës komuniste do jenë disa, dhe propozimet janë për Kampin e Tepelenës (1949-1951) dhe Mënikun (në Pezë), ku u zhvarrosën eshtrat e 22 intelektualëve të ekzekutuar për bombën në ambasadën sovjetike.

Në kuadrë të kësaj nisme, 30 gushti, dita ndërkombëtare të të zhdukurve me forcë është organizuar një aktivitet përkujtimor për viktimat që vuajtën dënimin në kampet e punës së detyruar gjatë regjimit komunist. Po këtë ditë, Autoriteti prezantoi projektin "Memoriali Kombëtar i Kampeve të Punës" në teatrin e qytetit Tepelenë.

30 gushtin e kaluar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bash-

këpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe Institutin e ish-të Përndjekurve Politikë prezantoi dy aplikacione online, të cilat do të ndihmojnë procesin e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri.

NDERIMET

Përpjekjet për të lartësuar përpjekjet e pashtershme të familjarëve për të kërkuar eshtrat dhe kthyer dinjitetin në vend, përmes propozimit për medalje për merita civile së pari, të 3 nënave që humbën fëmijët në ish kampin e internimeve Tepelenë, si dhe së dyti, një grupi qytetarësh dhe familjarësh që mundësuan gjetjen, identifikimin dhe memorializimin e vendvarrimit të fshehtë të 22 intelektualëve ekzekutuar pa gjyq me pretextin e hedhjes së bombës në ambasadën sovjetike.

AIDSSH ka koordinuar punën për vënie në jetë të projektit përkujtimor dhe edukativ, në kthimin e identitetit të viktimave të regjimit diktatorial, në qetësimin sadopak të shpirtit të viktimave të diktaturës komuniste, në veprimet për t'u njohur me të vërtetën, në përgjegjësitë për mënyrën si do ta trajtojmë të kaluarën tonë, etj. në respekt të së shkuarës e në emër të së ardhmes. Duke vlerësuar sakrificën dhe qëndruesën e disa të mbijetuarve të Kampit të Tepelenës që i dhanë kësaj përballjeje përmasë njerëzore, si personalitete frymëzuese për shoqërinë e sotme shqiptare, Autoriteti i ka sugjeruar Presidentit të Republikës, për dhënien e dekoratave dhe titujve të nderit sipas rastiit për

Gjelë e Mrika Gjikota dhe Drane Jakja (pas vdekjes. Njëherit për kurajën e njerëzve që treguan humanizëm në kushte çnjerëzimi, personalitete frymëzuese për shoqërinë e sotme shqiptare, me propozim të Autoritetit Presidenti u ka dhënë tituj nderi edhe Kadri Hysa, Faslli Hysa dhe Gëzim Mulla (të 3 pas vdekjes) si edhe Aleksandër Dhimës, Hysen Shehut e Osman Kacelit. Tashmë rruga që të çon në vend ekzekutimit e të martirizuarve për bombën në ambasadën sovjetike, është emërtuar "26 shkurti", duke synuar një pëlgriazh të dhimbjes e shpresës për zbardhjen e të vërtetave të mbuluar nga harrësia nis në vendin e ekzekutimit dhe përfundim në varrezat "Dëshmorët e Kombit", ku prehen sot të pushkatuarit pa gjyq të 1951.

Opinion

I Ditës

Kafenetë plot, shprehje mirëqenieje apo mjerimi?

Nga Xhevat Mustafa

(vijon nga faqja 1)

... kafeneve në zona të ngushta, por edhe qenia e tyre njëra më plot se tjetra, sidomos në orët e para-diteve me mot me diell, pa shi e të ftohtë. Ka të ngjarë që plot nga të huajt mund t'i bëjnë vetes ose njeri-tjetrit një varg pyetjesh. Punojnë apo nuk punojnë këta shqiptarët? Ku dhe si i gjejnë lekët për të jetuar dhe pirë kafe pa punuar? Si nuk lodhen dhe mërziten duke qëndruar ulur për 2-3 orë? Po pronarët dhe kamerierët e kafeneve si i lejojnë dhe durojnë të qëndrojnë kaq gjatë, e shumta duke paguar një filxhan kafe dhe duke debatuar, disa me zë të lartë, me duar e këmbë? Për çfarë bisedojnë përditë?

Natyrisht për ne shqiptarët e Shqipërisë pafundësia e kafeneve sup më sup apo bythë më bythë, plotësia e tyre e përditshme me klientë, nuk përbën më as risi, as çudi, as bezdi... Në fund të fundit është një nga zakonet, praktikant, traditat tona.

Ka një kohë bajagi të gjatë që lulëzimi dhe plotësia e kafeneve është bërë burim kënaqësie dhe mburrjesh për disa politikanë dhe qeveritarë, nënkuptohet të shumicave qeverisëse. Sipas mendjes, interesit politik dhe elektoral dhe llogarive të tyre "të holla", në çdo kafene punësohen të paktën 4 vetë, si banakierë dhe kamerierë. Kështu këta hiqen nga lista kilometrike e të papunëve dhe nuk i bezdisin më nëpër zyra dhe në takimet elektorale, duke u kërkuar një vend pune në këmbim të votës... Këto vitet e fundit, sidomos në Tiranë, hapja e një kompleksi kafenesh të reja, me ambiente komode dhe pajisje moderne, sidomos në zona të qendrës, nënkuptohet edhe me fatura më të larta edhe për një filxhan kafeje, po shfrytëzohet për shou apo pazar partiak, politik, elektoral, ekipor apo personal. Për ne që kemi lindur në fund të viteve 1940 e më vonë, këto "ceremoni festive" për një kafene apo tufë kafenesh, janë imitime banale dhe qesharake të "ceremonive madhështore" në kohën e diktaturës komuniste apo enveriane për inaugurimet e veprave të mëdha industriale, bujqësore, blegtorale të socializmit. Pas prerjes së shiritave të përmirimit të tyre nuk ndryshonte pothuajse asgjë në nivelin e jetesës sonë të përditshme, në xhepat e baballarëve dhe nënave, në raftet tona të ushqimeve, në tavolinat tona të thjeshta të ngrënies, bërë shoshë nga molat, të cilat këndonin shpesh, sikur i mbanin iso këngës së zorrëve tanë... Edhe nga kafenetë e reja apo komplekset e kafeneve moderne nuk mund të priten përmirësime të mëdha në nivelin e jetesës së shumicës së kamerierëve dhe banakierëve me paga rreth 15.000-25.000 lekë të reja në muaj, përfshirë edhe ato lekë që fitohen nga bakshishet. As për



pensionistët, që janë kafepirësit më të shumtë e më të rregullt, nuk do të ndryshojë gjë për mirë. Përgjithësisht, do të vazhdojnë të mblidhen po aty ku kafeja kush-ton më lirë, pa u joshur se në kafenetë e reja kafeja është vërtetë pak më e shtrenjtë, por edhe më e mirë si cilësi dhe shije. Sepse me ato pensione që marrin dhe me shtesat që u bën qeveria rrallë e për mall e sa për 7-8 shishe me dhallë, duhet të kaverdisen një muaj të tërë, për të ngrënë sa me mbush barkun, pa parë se me çfarë, për të paguar faturat e larta të korentit, ujit, internetit, celularit, barnave mjekësore jashtë listës së shkurtër të rimbursimeve, por sa më largofitë, edhe arkivolin, copëzën e tokës në varreza, drekën e varrimit, pllakat prej betoni apo mermeri të lirë të varrit... Për të pushteshtit apo qeveritarët e çdo niveli panumërsia dhe plotshmëria e kafeneve ka edhe disa të mira të tjera. I mbajnë ulur apo mbërthejnë qytetarët kafepirës nëpër karriqe, larg zyrave të tyre dhe larg shesheve të protestave. Domethënë, larg opozitarëve apo të pavarurëve kurajozë, shumë prej të cilëve ditëve të protestave i kursejnë apo sakrifikojnë kafetë e atyre mëngjeseve. Shumëkujt në Tiranë, sidomos në zonat pranë Parlamentit, Kryeministrisë, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bashkisë, u ka rënë në sy, se ndërsa mijëra qytetarë të zhgënjyer dhe të pakënaqur nga qeverisja "rilindase"

protestojnë, lodhen, ngioren, rrezikojnë sytë nga gazrat lotsjellës apo kokat nga ndonjë shkop gome i policisë, qindra të tjerë, shumica nga kontigjenti i tifozëve të së majtës apo i "të pavarurëve", i vështrojnë nga karriqet apo xhamat e kafeneve, me indiferencë, qesëndi, disa edhe me armiqtësi... Në këtë kuptim këta mund të quhen edhe "grevëthyes" apo "protesta-bojkotes". Natyrisht, si qytetarë të dy "ushtritë", ajo e atyre që protestojnë, qoftë me kërkesa politike dhe qoftë me kërkesa thjeshtë qytetare e njerëzore dhe ajo e kafepirësve të ngeshëm, që i vështrojnë si spektatorë apo edhe i tallin, nuk janë shumë larg njëra-tjetrës... Në të kundërt, janë shumë afër apo me ndryshime të pakta e minimale prej nga të ardhurat mujore, domethënë nga pagat dhe pensionet. Po kështu, i blejnë në të njëjtat tregje dhe me të njëjtat çmime ushqim e përditshme, veshjet, i paguajnë në të njëjtat farmaci dhe spitalë e me të njëjtat fatura ilaçet, analizat, kujdesin mjekësor... Në të njëjtat zyra dhe me të njëjtat çmime me tendencë rritjeje të vazhdueshme, ndryshe nga rrogat dhe pensionet, paguajnë edhe faturat e energjisë elektrike, të ujit, internetit, celularëve, biletat e avionëve dhe të autobusëve në linjat brenda qyteteve, për linjat e gjata... apo turistike. Disa nga politikanët dhe qeveritarët e pozitës, herë hapur e herë në vetvete ose duke folur vesh më vesh, që të mos i dëgjojnë votuesit e tyre "naivë" e "të shur-

dhuar" dhe "gazetarët veshëmprehtë", mburren se bollëku si numër dhe përplotësia me klientë e kafeneve, shpreh suksesin e tyre si ekip dhe si qeverisje në luftën kundër papunësisë dhe varfërisë?! Thënë ndryshe, i shikojnë dhe llogarasin si "shprehje të rritjes së mirëqenies", të "lumturisë", të "rilindjes". "Harrojnë" apo nuk duan të pranojnë se moria e kafeneve dhe e njerëzve brenda tyre në të vërtetë shpreh shumë më tepër brazëti xhepush, interesash, ambiciesh pozitive, erozion kulturor, intelektual... Nuk duan t'ia dinë për faktin se shumica e atyre që mbushin kafenetë nuk kanë mundësi financiare të blejnë laptopë e kompjuterë, qoftë edhe të përdorur, një revistë, një libër, një televizor të dytë, një dekoder të ri për programet HD, për ta kaluar në mënyrë të kulturuar kohën e lirë tejet të bollshme... "Harrojnë" se ata që punësohen apo punojnë nëpër kafene marrin paga qesharake, me të cilat nuk mund të sigurojnë një jetë normale për veten dhe jo më për një familje, me grua dhe dy fëmijë, kur dihet se çdo fëmijë, deri sa të bëhet për punë, kush-ton, e pakta rreth 20.000 lekë në muaj, domethënë mbi minimumin jetik në Shqipëri, ose sa gijra për një garsoniere apo apartament 1plus 1 në lagjet përreth qendrës në Tiranë. "Harrojnë", gjithashtu, se kafenetë janë edhe fole thashethemesh dhe debatesh bajate apo shterpe, virusesh, sëmundjesh, alkoolizimi... Por, jo rrallë herë janë bërë edhe burim rreziqesh, sidomos kur disa me maska apo kaska motorësh, zbrazin breshëri automatikësh, nga jashtë apo edhe nga brenda, mbi objektivin e tyre të radhës, ulur në ato minuta në një lokal mbushur me njerëz të tjerë, pa asnjë njohje dhe lidhje me atë... Kështu, bëhet e qartë se kafenetë e shumta dhe të mbushura plot me njerëz, që shtynjë paraditet me një kafe 50-70 lekëshe apo mbërmet me një teke raki sade, duke parë ndeshjet e futbollit, që nuk i shikojnë dot në shtëpi, se nuk i paguajnë dot paketat që ua mundësojnë ose, sepse nuk i lënë gratë e mbërthyer nga telenovelat amerikane, mund të kenë lexuar dhe dëgjuar edhe fakte, që dëshmojnë se Edi Ramës dhe ekipit të tij qeveritar, nuk u dridhen fare as qerpikët dhe as zemrat, kur firmosin dhe vulosin fatura tmerrësisht të larta për shokët deputetë dhe ortakët e tyre oligarkë. Hë, si thoni tani: kafenetë e shumta dhe plot janë shprehje punësimi, bollëku dhe mirëqenieje apo papunësie, varfërimi dhe mjerimi?

"...kafenetë e shumta dhe të mbushura plot me njerëz, që shtynjë paraditet me një kafe 50-70 lekëshe apo mbërmet me një teke raki sade, duke parë ndeshjet e futbollit, që nuk i shikojnë dot në shtëpi, se nuk i paguajnë dot paketat që ua mundësojnë ose, sepse nuk i lënë gratë e mbërthyer nga telenovelat amerikane, mund të kenë lexuar dhe dëgjuar edhe fakte, që dëshmojnë se Edi Ramës dhe ekipit të tij qeveritar, nuk u dridhen fare as qerpikët dhe as zemrat, kur firmosin dhe vulosin fatura tmerrësisht të larta për shokët deputetë dhe ortakët e tyre oligarkë. Hë, si thoni tani: kafenetë e shumta dhe plot janë shprehje punësimi, bollëku dhe mirëqenieje apo papunësie, varfërimi dhe mjerimi?"

TRAJNERI I PARTIZANIT

Nga ecuria negative, te titulli kampion, rivalët dhe akuzat për tolerime. Skënder Gega zbret personalisht në fushë për t'iu përgjigjur mbi gjithçka që rrethon skuadrën e tij në sprintin final drejt trofeut. "Tekniku si fillim ka hedhur poshtë të gjitha aludimet se humbja e fundit kundër Luftëtarit erdhi si pasojë e atij që çlësohet "futbolli i tavolinave". "Varet kush i

përflet rezultatet tona. Nëse dikush ka argumente teknike, jam gati të ballafaqohem me çdo njeri. Unë e di sa fort ka luftuar klubi dhe ky grup për të arritur këtu. Unë e njoh veten personalisht. Ne paragjykojmë edhe kampinatet e huaja, jo më Superioren. Ne jemi të ndërgjegjshëm për atë ç'ka bëjmë, respektojmë çdo opinion, por në fund respektojmë veten me shumë se të tjerët.

Gega në kundërsulm: Ballafaqohem me këdo, u detyrohem vetëm tifozëve

Lojtarët janë profesionistë. Në të gjitha ligat europiane ka surpriza, për fat të keq na ndodhi ne, do mundohemi ta korrigjojmë. Ky është premtimi jonë karshi tifozëve dhe atyre që kanë mbushur barkun me opinione të ndryshme, sepse nuk duan ta shohin Partizanin atje ku duhet. Nuk

më intereson fare", ka thënë Gega. Përtej misionit për t'u kthyer te fitorja, Gega refuzon ta cilësojë sfidën e së mërkurës vendimtare për titullin kampion. "Javën që kaloj unë thashë që kemi 9 finale. Nuk është finale e madhe me Skënderbeun, janë të gjithë finale. Edhe nëse fitojmë,

edhe nëse fitojmë ndaj Luftëtarit, sërish mbeten shumë ndeshje, të gjitha finale. Asgjë s'ka mbaruar. Është finale e javës në vazhdim. Është mirë që do luajmë me ekipe të mira. Me Kukësin në Shkodër treguam që dimë ta kontrollojmë veten", ishte komenti i trajnerit të Partizanit. Në fund edhe një mendim për rivalët e përjetshëm të Tiranës, në rrezik për t'u larguar nga Superliga dhe sigurisht akuzues kryesore sa i përket tol-

erimeve nga ana e kryesueseve në fundjavën e shkuar. "Është një aset i kampionatit shqiptar. Uroj që Tirana të jetë në elitë dhe të ketë gjithmonë derbi. Dinamo nuk ekziston, është për të ardhur keq. Do kisha qejf të ishin ekipe më me kualitet. Uroj të kthehet edhe Lushnja, Elbasani, Vllaznia sa më shpejt. Të rritet numri i klubeve me traditë. Sporti të plotëson jetën", ka përfunduar Gega.



Jeton Selimi

Në shkëputje siguron të artën me 156 kilogramë, ngre 183 në shtytje dhe renditet i dyti në dygarësh

Calja kampion Europe në shkëputje, nënkampion në shtytje e dygarësh

Shtërmenasi shkëlqen në pedanë në peshën 73 kilogramë

Kampioni i Europës në peshën 69 kilogramë, Briken Calja, vinte në Europeanin e Batumit me një bast të madh për veten, duke garuar në peshën 73 kilogramë. Por pak rëndësi ka kjo, pasi talenti nuk bëhet ujë dhe shtërmenasi i ekipit kuqezi shkëlqen në pedanë në stilin e shkëputjes. Calja hyri në garë me 151 kilogramë, duke bërë një provë mjaft të bukur. Bjellorusi Likharaad ngre 153 kg dhe e detyron Caljen ta ngrejë shtangën në 156 kilogramë, dhe ta çojë me sukses duke vendosur një rekord personal. Likharaad kërkon ta barazojë Caljen, por dështon dy herë në 156 kilogramë dhe Calja automatikisht shpallet kampion i Europës. Gjithsesi për Brikenin ka dhe një provë të tretë, por tashmë, me medaljen e artë të siguruar, synon rekordin europian me 160 kilogramë, por nuk ia del dot mbanë. Në përfundim të garës, Briken Calja e mbyll i pari me 156 kilogramë, në vendin e dytë bjellorusi Likharaad me 153 kilogramë dhe i treti bullgari Andreu me 153 kilo-



EUROPIANI I PESHËNGRITJES	
PESHA 73 KILOGRAMË	
RENDITJA SHKËPUTJE	
Briken Calja	158 kg
Vadzim Likharaad	153 kg
Andreu Bozhidar	153 kg
RENDITJA NË SHTYTJE	
Andreu Bozhidar	192 kg
Briken Calja	183 kg
David Sançez	183 kg
RENDITJA NË DYGARËSH	
Andreu Bozhidar	345 kg
Briken Calja	339 kg
Vadzim Likharaad	335 kg

parë dështon, pasi gabon momentin e ngritjes së peshës nga supet. Por në tentativën e dytë ai nuk e përsërit gabimin dhe ndonëse pozicionohet me vështirësi, arrin ta kalojë provën. Bullgari Andreu me 187 kilogramë e tij merr vendin e parë në shtytje dhe në dygarësh, çka e detyron Caljen të ngrejë shtangën në 188 kilogramë për të kapur medaljen e artë në dygarësh. Por fati nuk e do Caljen, që me shtangën mbi kokë, nuk arrin të pozicionohet dhe i dorëzon medaljen e artë në shtytje dhe në dygarësh bullgarit Andreu, ndërsa Brikeni ynë është medalje argjendi në shtytje e dygarësh, ndërsa medalje ari në shkëputje.

KORÇARËT

Skënderbeu me shumë probleme para Partizanit

Në mënyrë të pa prit, Skënderbeu e sheh veten sërish në garë për të siguruar një vend në Europë, fundja diferenca me Teutën e vendit të tretë është vetëm tre pikë larg. Kalendarit i rezervon Skënderbeut këtë mesjavë kundërshtarin më të fortë të mundshëm, Partizanin, për më tepër që të kuqtë kërkojnë me çdo kusht tre pikët për të dalë nga ajo mini krizë që i futi Luftëtarit brenda pak ditësh. Skënderbeu është nga të paktët ekipi që di si mposhtën Partizanin. 2 nga 3 përballjet ndërmjet tyre këtë sezon, ekipi i Orges Shehit i ka fituar. Kundërshtari nuk është problemi më i



madh i korçarëve në këtë sfidë, shqetësues është fakti që Shehit i mungojnë jo pak, por katër lojtarë në këtë transfertë, plus që një pjesë e mirë e titullarëve nuk po kalojnë një formë të mirë fizike. Shqetësues mbetet forma e kapitenit Marko Radas, eksperiencia e tij është jetike në qendër të

mbrojtjes. Gjithashtu, dy senatorët të tjerë Kristi Vangjeli dhe Gjergji Muza-ka ende nuk janë rikuperuar plotësisht, vijojnë të kenë shqetësime muskulore. Mungesë e sigurt pritet të jetë ajo e mesfushorit Shqipërim Taipi ndërsa dhe prezenca e Sibò është në pikëpyetje.

"Vullnetarët" kuqezi premtojnë

Musta dhe Kale: Do ta mposhtim Teutën




Flamurtari do të presë sot Teutën në sfidën e parë të fazës së fundit të superligës, me kuqezi të që përpos 1001 halleve, janë vetëm 2 pikë larg durrsakëve të vendit të tretë dhe në 90 minutëshin e radhës kanë në dorë një mundësi të shkëlqyer për t'i parakaluar ata. Në konferencën e radhës për shtyp të vlonjatëve, ishin Musta e Kale ata që folën për takimin e nesërm. "Ishte një fitore shumë e vlefshme për ekipin ajo me Tiranën. Besoj se na bëri shumë punë, sepse ndihemi për ndeshjen e ardhës, që është vërtet shumë e vështirë. E rëndësishme është që ambienti është pozitiv te Flamurtari në këtë moment. Teuta? Të gjitha ndeshjet janë të vështira. Kam luajtur me Teutën

më parë, por pak lojtarë kanë mbetur nga ajo kohë. Ka lojtarë, që sezonin e shkuar ishin me ne në ekip, si Bicaj, Bushic etj. E përsëris, është një ndeshje radhe, që duhet ta fitojmë", - ka thënë Musta. Braziliiani Kale ka theksuar se Flamurtari duhet t'i fitojë patjetër ndeshjet brenda: "Ne

luajmë në shtëpi dhe ndeshjet në shtëpi duhen fituar të gjitha. Pra, ne luajmë vetëm për tri pikët. Europa është një objektiv i mundur, edhe pse janë edhe disa ekipe që pretendojnë aktualisht. Do të luftojmë fort deri në fund për t'ia arritur qëllimit", - tha Kale.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 2. Gjëja e latinëve.
- 5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
- 9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
- 11. Ministri Ekonomie e Pune
- 13. Marubi i fotografisë.
- 14. Bel i Mapupassant.
- 15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja.
- 18. Derek aktore.
- 19. Gjysmë totale.
- 20. Eshhtë art i të folurit
- 22. Një patriark biblik.
- 24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
- 26. Janë dëshmorë të kishës.
- 28. Eshhtë lloj papagalli.
- 29. Eshhtë lloj papagalli.
- 30. Qerre pa qe.

- 32. Ekstre në numërim.
- 33. Eshhtë bodrumi.
- 34. Steiger aktor.
- 35. Inicialet e Delon.
- 37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
- 38. Një mund të jetë autonome.
- 40. Në krye të evidencës.
- 42. Edgar Allan Poe.
- 44. Ekstremet në litar.
- 46. Giorgio i modës.
- 50. Janë malet me Akonkagua.
- 52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

VERTIKAL

- 1. Novarro që qe aktor.
- 3. Kusturica regjisor.
- 4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
- 6. Inicialet e Kazan.
- 7. Ishte qyteti i 100 portave.
- 8. Pinci i Dy herë mat.
- 9. Janë të mirat që prodhohen.
- 10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njohur.
- 11. Një markë celulari.
- 12. Ushtrohej nga filibustierët.
- 16. Një përsiatje.
- 17. Agjenci Informative Tiranë.
- 21. Një brejtës pylli.
- 23. Një Gjon që qe aktor i yni.
- 25. Titulli i Byron.
- 27. Në radhë të parë.
- 31. Emri i Amundsen.
- 36. Moore aktore.
- 39. Pishtarë pa pishë.
- 41. Gjysmë vatani.
- 43. Rruga e Molnar.
- 45. Një fazë gjumi.
- 47. Inicialet e Redford.
- 48. Në krye të notarëve.
- 49. Inicialet e Reitman.
- 51. Unë dhe ti.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Nuk kalohet nga mbetësi.
- 5. U printe gladiatorëve
- 12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
- 14. Tatum që qe pianist.
- 15. Një që lufton për para
- 16. Mund të bëhet me safari
- 17. Breshkat luftarake të kartonave
- 19. Ngjitet kur nuk nget
- 20. Në mes të rrugës
- 21. Sporti me rikisha
- 25. U shkrua nga Hesiodi
- 26. Një sferë për model
- 27. Mbyllin një sirtar
- 28. Makina Tipò
- 30. Inicialet e Bean, aktor
- 31. Nino, kompozitor i famshëm italian
- 33. Ramiro pa zë.

VERTIKAL


- 2. Ishin grekët në trojë
- 3. Ishin palate të beut
- 4. Goodëin, ndihmësi i Nero Wolfe
- 5. Pak sinqeritet
- 6. Personazhet e Charles Schulz.
- 7. Kompozoi Mefistofele
- 8. Në radhë të parë.
- 9. Qytet zviceran
- 10. Në krye të kryesisë
- 11. Ughi violinist
- 13. Carlos që qe pilot i Formula 1
- 15. Ekstre në muzg
- 18. Inicialet e Steinbeck
- 22. Gruda, "Njeriu me top"
- 23. Eshhtë X ajo e sulmit
- 24. Paradhoma e parajasës
- 28. Eshhtë edhe ai i luftës
- 29. Janë edhe ato të cirkut
- 31. Mbarojnë fare
- 32. Inicialet e Reed, aktor
- 34. Të parët në sondazh
- 36. Eshhtë taksa
- 38. Një mund të jetë emërore
- 39. Një pjesë e marrëzisë
- 41. Gjysmë mimize
- 42. Hundë kur s'jam unë
- 43. Skuadër greke
- 44. Lempër, këngëtare gjermane
- 46. Fundi i një akti



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		3		2				9
8								6
5	7			1				4
	1	6					2	
7					9			
						3		7
		7	9					
								1
			5	7				6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9


Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	7	6	3	8	9	4	5	1
1	4	9	2	5	6	3	8	7
5	8	3	1	4	7	9	2	6
3	1	7	6	9	2	5	4	8
4	5	2	7	3	8	6	1	9
9	6	8	4	1	5	2	7	3
6	9	1	5	7	4	8	3	2
7	2	4	8	6	3	1	9	5
8	3	5	9	2	1	7	6	4

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

H	E	S	A	P	E	T	P	A	B	C			
E	M	I	R	A	T	E	A	R	A	B	E	T	
L	I	K	E	R	B	E	T	O	N	E	T		
E	I	L	S	A	D	R	I	V	A	L	E	T	
N	R	B	U	R	I	M	E	T	J	A			
M	A	R	O	K	E	N	E	O	D	A	T		
F	U	L	L	A	N	I	E	M	E	A			
P	A	N	L	A	S	T	O	M	I	K	E	A	
P	A	N	R	S	T	E	R	A	O	L	E	T	
P	A	N	A	N	I	A	P	R	E	S	I	O	N
S	A	R	D	O	U	D	E	T	I	T	A		
P	A	R	A	G	R	A	F	I	V	A	N		
I	R	O	N	I	A	B	A	N	A	R	A	T	
R	A	B	A	T	E	A	N	V	R	I	M	A	T
A	N	E	R	T	E	L	E	M	A	K	U	L	E
T	S	P	O	L	E	M	I	K	A	E	L		
V	K	A	N	A	R	I	N	A	E	N	A		
A	L	V	A	T	I	K	A	N	I	E	N		
J	O	E	T	N	E	T	E	M	A				
A	R	I	M	A	T	R	A	D	E	T	I	A	
A	R	I	A	N	A	R	U	N	I	K			
T	A	L	E	N	T	M	A	U	R	I	C	E	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Argëtim filozofik

- Duhet të shohësh dhe të dëgjosh, por dhe të dish të heshtësh.

- Disa njerëz janë si retë, kur zhduken ... dita bëhet më e bukur !!!

- Njerëzit thonë se e duan shiun, por hapin çadrat kur bie shi!

Njerëzit thonë se e duan diellin, por kërkojnë hije kur dielli del!

Njerëzit thonë se e duan erën, por kur era fryn dritaret janë të mbyllura!

Prandaj dhe unë buzëqesh kur dëgjoj njerëzit të thonë se më duan!

Thënie të mençura

- - Ndonjëherë njerëzit hedhin diçka të mirë për diçka më të mirë, për të zbuluar më vonë se e mira ishte mjaft e mirë, dhe më e mira ende nuk ka ardhur.
- - Nëse në të njëzetat nuk mëson,
- në të tridhjetat nuk bën,
- në të dyzetat nuk keni,
- atëherë në të pesëdhjetat as nuk do të mësosh, as nuk do të bësh, dhe as nuk do të keni.

